



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit me Karakter Profesional

**“Teknik i Lartë Elektrikë” me profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”,
“Elektromekanike”,**

Kolegji Universitar i Biznesit

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Dr. Klodian Dhoska

Dr. Eli Vyshka

Shtator/ 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë Elektrikë”, me profile
“Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”.**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar i Biznesit
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Studimeve të Larta Teknike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë Elektrikë” me profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër MAS nr. 319, datë 27.06.2023
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 5-të në KSHK
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2023 – 2024 4 PAE/ 6 PAK 2024 - 2025 8 PAE/ 4 PAK
18	Numri i studentëve për dy vite (2023- 2025):	2023 – 2024 20 studentë 2024 - 2025 26 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë Elektrikë” (TLE) me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” është hapur me Urdhër MAS me nr. 319, datë 23.06.2023 dhe ofrohet nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit”, i licensuar si Akademia Profesionale e Biznesit me VKM nr. 651, datë 14.09.2011.

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar “Teknik i Lartë Elektrikë” (TLE) me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” është Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTL).

Njësia Kryesore në të cilën bën pjesë DSLTL është Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (më tej KSLP) i Institucionit të Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit” (KUB).

Departamenti i Studimeve të Larta Teknike është njëri nga 2 (dy) departamentet e Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale, të IAL “Kolegji Universitar i Biznesit” (KUB).

Programi i studimit 2-vjeçar me karakter profesional “Teknik i Lartë Elektrikë” me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Diplomë Profesionale” në “Teknik i Lartë Elektrikë” me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”, referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi në dy vitet (2023-2025) është 47 studentë

KUB ka aplikuar në ASCAL më datë 22.05.2024 (Shkresë e IAL nr. 239/1 Prot, datë 22.05.2024), për akreditimin të parë të këtij programi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Për hartimin e raportit, veç Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (më tej RVB), dokumentave mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që ai kreu në institucion në datat 27-28 Maj 2025. Gjithashtu ai mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Njësishë të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, së Sekretarisë, Bibliotekës, etj.

Në bazë të vlerësimit të jashtëm janë: Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, disa elementë të Ligjit për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve nr. 10247/2010, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me Vendim nr. 824, datë 24.12.2021 të Këshillit të Ministrave (sipas shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij për standardet shtetërore për sigurimin e cilësisë për programet e studimit 2-vjeçar me karakter profesional), si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave të sjella nga KUB në DVV dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në vend. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që mbulojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Koordinatori teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është Msc. Anilda Beqiraj

Kolegji Universitar i Biznesit është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm në datë 01.09.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 97/15, datë 01.09.2025. Institucioni njofton për komentet në ASCAL më datë 09.09.2025, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 458, datë 09.09.2025. IAL



Referuar shkresës nr. 458 datë 09.09.2025 të Kolegjit Universitar të Biznesit në të cilën përcillen komentet mbi draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit 2-vjeçar me karakter profesional “Teknik i Lartë Elektrik”, me tre profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm paraqet si më poshtë vlerësimet përfundimtare.

Standardi I.1- Kriteri 4 (fq 8) dhe **Standardi II.5 Kriteri 3** (fq 30): *Duhet të bëhej një studim më i detajuar për të tre profilet “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”,*

Kolegji Universitar i Biznesit e vlerëson rekomandimin, por sqaron se për gabim të Grupit të punës nuk ishte ngarkuar në sistem evidencën e saktë për studimin e tregut për të tre profilet “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” (u ngarkua evidenca nr. 26/1 në sistem me datë 17.09.2025).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u njoh me evidencën e saktë për studimin e tregut për të tre profilet “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”, dhe vlerëson se ishte kryer një studim i detajuar të tregut.

Në përfundim, komenti i institucionit **pranohet**.

Standardi I.1- Kriteri 4, Konkluzione (fq 10): *që këto analiza (të përfitimeve nga marrëveshjet e nëshkruara) të realizohen në formën e raporteve të shkruara vjetore, ku të analizohet më me hollësi se çfarë duhet të përmirësohet në këto bashkëpunime,*

Kolegji Universitar i Biznesit sqaron se nuk është diplomuar brezi i parë i studentëve të programit “Teknik i Lartë Elektrik” me tre profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”, por ka bashkëlidhur listat e subjekteve ku studentët kanë kryer praktikën dhe vlerësimin e tyre në pikë.

Si përfundim, komenti i institucionit merret në konsideratë dhe **pranohet**, por Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nënvizon se këto analiza duhet të bëhen në vitet në vijim

Standardi II.1- Kriteri 6 (fq 17): *Institucioni duhet të bëjë një analizë të IAL-ve në Shqipëri që ofrojnë program të ngjashëm dhe të shprehet për përmbajtjen e këtij programi,*

Kolegji Universitar i Biznesit është dakort me sygjerimin dhe e ka konsideruar që në fillim këtë, si edhe ka shtuar në dokumentat e ngarkuara në sistem me datë 17.09.2025, ngjashmërinë me UAMD dhe KPT.

Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson pozitivisht këtë sqarim.

Në përfundim, komenti i institucionit **pranohet**.

Standardi II.4- Kriteri 6 (fq 27): *syllabuset duhet të jenë ato aktuale jo të vjetrat (pra me pedagogët që kanë zhvilluar mësimin e lëndëve në v.a. 2023-2025),*

Kolegji Universitar i Biznesit është dakort, por sqaron se në dokumentat e DVV janë vendosur syllabuset e hapjes së programit, jo ato aktuale dhe ka ngarkuar në sistem me datë 17.09.2025 syllabuset e vitit aktual 2024-2025.

Si përfundim, komenti i institucionit merret në konsideratë dhe **pranohet**, por Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nënvizon se **literatura duhet të përditësohet e të jetë ajo e 5 viteve të fundit**.

Standardi III.5- Kriteri 7 (fq 43): *KUB nuk ka paraqitur formatin e Diplomës dhe suplementin për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”,*

Kolegji Universitar i Biznesit e pranon vërejtjen, por sqaron se për shkak të ngarkesave të punës gabimisht nuk ishte ngarkuar në sistem evidenca e formatit të Diplomës e suplementit për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me tre profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” (u ngarkua evidenca nr. 77 në sistem me datë 17.09.2025).

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u njoh me evidencën e formatit të Diplomës e suplementit për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me tre profilet “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” dhe i gjen ato të regullta.

Në përfundim, komenti i institucionit **pranohet**.

Standardi IV.1- Kriteri 2 (fq 48): *rekomandon ribërjen e saktë të tabelave 4 dhe 12.2 tek tabelat përmbledhëse 1-24,*

Kolegji Universitar i Biznesit e pranon vërejtjen dhe sqaron se janë ngarkuar gabimisht evidencat e një programi tjetër studimi.

Grupi i Vlerësimit nuk gjeti të ri-ngarkuara tabelat përmbledhëse 1-24 për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me tre profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”.

Në përfundim, komenti i institucionit nuk **pranohet**.

**VLERËSIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL NË
“TEKNIK I LARTË ELEKTRIKË” ME 3 PROFILE “ENERGJETIKË”,
“AUTOMATIZIM INDUSTRIAL”, “ELEKTROMEKANIKE”**

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Kolegji Universitar i Biznesit ka për mision të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standarteve të demokracisë në vend. GVJ gjatë gjithë procesit të vlerësimit të jashtëm, nga informacioni i marrë në DVV, nga takimet e zhvilluara me të gjithë faktorët dhe aktorët, por edhe nga njohjet e tij mendon se misioni i KUB dhe programi i studimit “Teknik i Lartë Elektrikë” (TLE) me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” është në përputhje me interesat kombëtare. Si theksohet edhe në Strategjinë 2024-2030, “... Vizioni i KUB është të forcojë trashëgiminë dhe reputacionin akademik e shkencor për të krijuar një model të arsimit të lartë që kombinon standartet akademike me aplikimet më bashkëkohore”. Evidenca 2: Statuti KUB Evidenca 1: Strategjia 2024-2030
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	GVJ gjykon se (sipas Statutit të KUB dhe DVV) programi i studimit profesional 2 vjeçar në “Teknik i Lartë Elektrikë” me 3 profile “Energjetikë”, “Elektromekanike”, “Automatizim Industrial”, është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e KUB, si dhe me fushën e veprimtarisë akademike dhe profesionale. KUB duke pasur parasysh stadin në të cilin ndodhet vendi ynë dhe qëllimin kombëtar të integritetit në familjen europiane, e konsideron sfidën më të rëndësishme të kohës shndërrimi i këtij institucioni ... në një IAL të nivelit të lartë duke synuar mënyrën e të menduarit globalisht dhe duke kultivuar vetëdijen kozmopolite si dhe duke nxitur një kulturë të re dhe inovative të të nxëniet, të cilave ju përgjigjet edhe programi i studimit “Teknik i Lartë Elektrikë” me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”.

	Evidenca 1: Strategjia 2024-2030 Evidenca 2: Statuti KUB Evidenca 3: Rregullorja KUB
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Nga leximi i dokumentave si: “Strategjia 2024-2030”, “Rregullore e Programit të studimit”, Organigramën e KUB, etj, GVJ mendon se programi i studimit “Teknik i Lartë Elektrikë” me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” është në përputhje me kërkesat e këtyre dokumentave, si dhe ka përputhje me fushat që mbulohen nga Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTL). Mendojmë se strategjia për të ofruar programe të tilla 2 vjeçare inxhinierike, i shërben shumë mirë ekonomisë. Evidenca 1: Strategjia 2024-2030 Evidenca 2: Statuti KUB Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit, neni 3
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Sipas RVB e DVV, GVJ konstaton se është bërë studim tregu për riorganizimin e Njesisë Kryesore: Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale, të mbështetur në të dhëna konkrete. Sa i takon Departamentit të Studimeve të Larta Teknike, të riorganizuar në vitin 2023, pranë Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale, <i>u një studim tregu për programin “Teknik i Lartë Elektrikë”.</i> Sipas takimeve në institucion, GVJ konstaton se për organizimin e programeve të studimit dhe planeve mësimore, KUB konsultohet me përfaqësues të bizneseve, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse, për t’iu përgjigjur sa më mirë dhe në kohë kërkesave të tregut të punës. Evidenca 15: Strategjia e KUB 2024-2030 Evidenca 26: Studim tregu profesional Evidenca 17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KUB Evidenca 57 Raporti vjetor KUB 2023-2024
Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga tabela e të dhënave për stafin akademik që realizon kurrikulën e programit të studimit, rezulton se në vitet akademike 2024-2025 janë përfshirë personel akademik i kualifikuar, i përshtatshëm për lëndët që kanë mbuluar. Në të gjitha vitet personeli akademik ka qenë me tituj/grada apo kualifikime sipas kërkesave ligjore. Nga tabela rezulton se nga 7 pedagogë, 2 pedagogë kanë titullin Prof. As. Dr. 1 ka gradën Dr. dhe 4 të tjerët janë me kualifikimin Msc. Përveç kësaj në programin “Teknik i Lartë Elektrikë” me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” janë të angazhuar në mësimdhënie edhe pedagogë me kohë të plotë nga fakultetet apo departamentet e tjera të KUB, me

	kualifikimin e duhur. Sipas shkresës 224, datë 26.05.2023, të Administratorit dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se KUB ka burimet e duhura (auditorë, laboratorë, bibliotekë, mjete didaktike, etj), të cilat janë në shërbim të programit TLE që ofron ky institucion. Evidenca: Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela nr. 1, nr. 4 Evidenca 56: Lista e plotë e stafit KUB Evidenca 60 Lista e stafit të KSLP Evidenca 69: Infrastruktura + laboratorët – Relacion mbi infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse të KUB
Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	GVJ vlerëson që programi i studimit profesional 2-vjeçar “Teknik i Lartë Elektrikë”, me 3 profilet e tij “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” ofrohet nga Departamenti i Studimeve të Larta Teknike, në përputhje të plotë midis fushës së studimeve me strukturën akademike e kërkimore të tij. KUB ka përcjellë pranë MAS propozimin për kodifikimin e programeve, të cilat janë bërë në përputhje me Udhëzimin e MAS, nr. 31 datë 15.11.2022 “Për proceduarat e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë”. Rezulton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë Elektrikë” me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”. Kodi i këtij programi është 52-PP-0713-S. Evidenca 60: Lista e stafit të KSLP Evidenca 85: Raporti i konferencave 2020-2025 Evidenca 36: Book of proceedings dhe Revista shkencore Evidenca 24: Shkresa e MAS për kodifikimin e programeve me nr. 7381/19 prot., datë 30.12.2024
Konkluzione - Kolegji Universitar i Biznesit ofron programin e studimit me karakter profesional 2-vjeçar, “Teknik i Lartë Elektrikë”, me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë bazë Departamenti i Studimeve të Larta Teknike përgjegjës për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare. - Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. - Rezulton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë Elektrikë”, me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike”,	

(cedy shly)

(for)

mbështetur në Udhëzimin e MAS, nr. 31 datë 15.11.2022. Kodi i këtij programi studimi është 52-PP-0713-S.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në dokumentat e paraqitura nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm për programin “Teknik i Lartë Elektrikë” jepen mjaft të dhëna për marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Evidenca 3: Statuti KUB, Kreu II, neni 11-13.1, III, V Evidenca 80: Kontrata pune për staf akademik Evidenca 9: Raporti Puna kërkimore, shkencore, projektet dhe inovacioni 2019-2024 Evidenca 30: Raport vjetor i DSLT
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga të dhënat që referohen në RVB dhe nga dokumentat në DVV, GVJ konstaton se KUB, DSLT kanë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi, me institucione homologe brenda vendit, si: Universitetin Politeknik të Tiranës UPT, Universitetin “A. Moisiu” të Durrësit UAMD, Universitetin Bujqësor Tiranë UBT, Universiteti Metropolitan i Tiranës, Kolegjin Universitar Luarasi, si edhe jashtë vendit me rreth 30 universitete, si: Webster University USA, International Black Sea University Gjeorgji, Istinye University Turqi, University College Leuven VZW Belgjikë. Këto bashkëpunime përfshijnë si synimet për shkëmbime stafi, shkëmbime eksperiencash mësimdhënëse, ashtu edhe për këmbime studentësh. KUB është pjesë e Konferencës së Rektorëve, si dhe merr pjesë në forumet e ndryshme të IAL-ve. GVJ nga DVV si dhe takimet në vizitë evidenton se KUB është shpalluar fitues në disa projekte të rëndësishme, në kuadër të

	shkëmbimit të eksperiencave, mobilitetit, rritjes së kapaciteteve në nivel institucional. Gjithashtu marrëdhënie bashkëpunimi KUB ka vendosur edhe me aktorët e biznesit. Për këtë program studimi janë nënshkruar rreth 50 marrëveshje, që shërbejnë në realizimin me cilësi të programit të studimit. Evidenca 8: Lista e marrëveshjeve për praktikat 2023-2025 (tabela nr. 5 tek tabelat përmbledhëse 1-24) Evidenca 17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KUB Evidenca 9: Performanca shkencore e KUB (lista e projekteve)
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.	GVJ nga DVV konstaton se KUB në përputhje me objektivat e veprimtarisë zhvilluese synon të ndërtojë ura bashkëpunimi me biznesin vendas dhe të huaj, duke mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale dhe punësimin eventual të studentëve pas përfundimit të studimeve, KUB e DSLT kanë marrëveshje bashkëpunimi me aktorët e biznesit vendas dhe të huaj. Aktualisht janë rreth 27 marrëveshje të lidhura vetëm për programin e studimit TLE. Lista e partnerëve gjendet edhe në faqen e internetit të KUB https://kub.edu.al/partneret/ Nga takimet, GVJ konstatoi se ka patur mobilitete të studentëve në Sllovaki, për shkak të ngjashmërisë së programeve të studimit. GVJ mendon se këto marrëveshje janë të përshtatshme për realizimin e objektivave të procesit mësimor, si realizimin e praktikave profesionale, ashtu edhe kërkesat për mobilitet studentësh. Evidenca 2: Statuti KUB, Neni 7 Vendosja e marrëdhënieve institucionale Evidenca 57: Raporti vjetor i KUB për v. 2023-2024, mobilitetet fq 38 Evidenca 11: Rregullorja për praktikën mësimore Evidenca 8: Lista e marrëveshjeve për praktikat 2023-2025 (tabela nr. 5 tek tabelat përmbledhëse 1-24)
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të	GVJ konstaton se në DVV është vendosur raporti vjetor i analizës së punës së KUB/departamentit dhe në këtë raport është analizuar edhe praktika mësimore dhe bashkëpunimi me kompani të ndryshme. Po kështu është edhe raporti i praktikave, ku jepen njoftimet dhe mënyra e plotësimit të dokumentacioneve e vlerësimi i studentit për praktikën e kryer. <i>Por referuar kriterit majtas dhe dokumentacionit në DVV, nuk ka raport analitik të</i>

studimit.	veçantë, të përfitimeve nga marrëveshjet e nëshkruara. GVJ, sugjeron që këto analiza të realizohen në formën e raporteve të shkruara vjetore, ku të analizohet më me hollësi se çfarë shkoi mirë dhe çfarë duhet të përmirësohet në këto bashkëpunime. Evidenca 3: Rregullore KUB, Kreu XIII Praktikat profesionale, nenet 102-103 Evidenca 23: Rregullore e programit TLE, neni 10 Praktikat profesionale Evidenca 11: Rregullorja për praktikën profesionale në KSLP Evidenca 12: Udhëzues për praktikën profesionale Evidenca 30: Raporti vjetor i DSLT 2023-2024 Evidenca 8: Lista e marrëveshjeve për praktikat 2023-2025 (tabela nr. 5 tek tabelat përmbledhëse 1-24)			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	GVJ konstaton se në RVB është deklaruar se KUB/DSLTP ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. Programi i studimit TLE është hapur për herë të parë në vitin 2023-2024 dhe në këtë vit 2024-2025 diplomohet dhe punësohet më pas brezi i parë i studentëve. GVJ takoi përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), të cilët treguan se kishin marrë disa inisiativa si aktivitete promovimi, etj, që nxisin punësimin e studentëve të diplomuar. Gjithashtu GVJ konstatoi se studentët e intervistuar, megjithëse pa përfunduar akoma studimet ishin të punësuar në biznese familjare, etj. Evidenca 62: Gjurmimi i studentëve, statistika të punësimit Evidenca 34: Statistika të punësimit			
Konkluzione				
- GVJ konstaton se KUB/DSLTP kanë siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, etj. - Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë kryesisht kompani të profilit elektrik, që ndihmojnë në kryerjen e praktikave profesionale e ku studentët mund të punësohen pas diplomimit. - Për programin “Teknik i Lartë Elektrikë”, me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” në vitin akademik 2024-2025 diplomohet brezi i parë i studentëve.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e DVV, GVJ konstaton se KUB ka struktura të ngritura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. Strukturat përgjegjëse institucionale deklarohen në organigramë. SBC realizohet nga vetë KUB nëpërmjet: • Strukturave hierarkike organizative (organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese) të KUB, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e akteve rregullatore, të politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij. • Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Evidenca 2: Statuti KUB, Kreu IX, Nenet 81-82 Evidenca 6: Rregullore e NjSBC https://kub.edu.al/organigrama/ Evidenca 58: Vendim SA nr. 11, datë 30.09.2024 për ngritjen e Strukturave mbështetëse
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Nga DVV, RVB dhe nga takimi me përfaqësues të NJSBC u konstatua që në KUB janë ngritur dhe funksionojnë strukturat e Sigurimit të brendshëm të cilësisë. NJSBC është ngritur me VSA dhe funksionon në nivel institucioni, në formën e një ekipi të përbërë nga 2 pedagogë, një përfaqësues nga njësitë ndihmëse, një anëtar - ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues nga studentët. Edhe në planin strategjik të KUB për v. 2024 – 2030 vihet theksi te cilësia me studentin në fokus. Evidenca 6: Rregullore e NjSBC Evidenca 7: Raport vjetor i NjSBC 2023-2024 (rezultatet e pyetësorit të studentëve) Evidenca 5: Raport IEQ për vlerësimin e cilësisë 2023 Evidenca 4: Raporti Grand Thornton Audit i jashtëm Evidenca 18: Pyetësorët për studentët dhe pedagogët Evidenca 1 + 15: Plani strategjik i zhvillimit të KUB 2024-2030, pika 5.7 Prioritetet në politikat dhe mekanizmat e sigurimit të cilësisë



Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Nga RVB dhe DVV, GVJ konstatoi se KUB harton politika dhe ngre struktura përkatëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë si dhe krijon kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së jashtme të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë. Treguesit për sigurimin e cilësisë në KUB janë të përfshira në: • Kodin e Cilësisë, standardet dhe kriteret përkatëse të të cilit përbëjnë treguesit e matshëm për sigurimin e cilësisë; • Aktet rregullatore (të procesit mësimor, në rregullat e sigurimit të laboratorëve, shëndetin dhe sigurinë e studentëve, etj) Instrumentet për sigurimin e cilësisë në KUB janë: • Raportet vjetore të institucionit; • Planet e punës mbi mbikëqyrjen dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë akademik dhe administrative të KUB; • Pyetësorët, etj; • Bashkëpunimet për ekspertiza (përfaqësuesit e bizneseve, ekspertët e jashtëm); KUB i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe periodik institucional sikurse dhe të programeve të studimit, vizitat monitoruese të MAS mbi kapacitetet akademik dhe infrastrukturore, në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik, përmbushja e raportimit për verifikimin e kontrollit të ligjshmërisë ndër vite, etj. Akreditimi i parë institucional u bë në vitin 2012, akreditimi periodik institucional është bërë me 2017, si edhe në 2022 me VBA nr. 3, datë 07.01.2022. Gjithashtu, është bërë akreditimi i pjesshëm institucional, me VBA nr. 53, datë 09.11.2020, për shkak të hapjes së Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale (KSLP), me urdhër të MASR nr. 139 datë 23.03.2018. Akreditimi i programeve të studimit 2 vjeçare me karakter profesional në “Teknik i Lartë”, me profile: “Sisteme Kompjuterike”, “Sisteme Elektrike”, “Sisteme Motorike” me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 73, datë 18.12.2020. Programi i studimit “Teknik i Lartë Elektrikë”, me 3 profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial”, “Elektromekanike” filloi veprimtarinë për herë të parë në v.a. 2023-2024 me Urdhër të MASR nr. 319, datë 27.06.2023. Evidenca 2: Statuti KUB, Kreu IX, Nenet 81-82 Evidenca 54: Urdhër MASR nr. 319, datë 27.06.2023 (TLE) Evidenca 65: Urdhër MASR nr. 139, 23.03.2018 hapja e KSLP
--	---

	si njësi kryesore Evidenca 66: Vendim BA nr.3, 07.01.2022 akreditim periodik i KUB Evidenca 51: Urdhër Rektor nr. 118, datë 26.02.2025 për ngritje GVB për akreditimin të programit TLE
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	Në rregulloren për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë (të matshëm, që pasqyrojnë arritjet dhe dobësitë). NJSBC vlerëson efikasitetin e veprimtarive akademike, të institucionit dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Raportet diskutohet në të gjitha njësitë e institucionit, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në kryerjen e këtyre veprimtarive në të ardhmen. Nga RVB dhe DVV shoqëruese, GVJ konstatoi se KUB në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar. Evidenca 6: Rregullore e NjsBC Evidenca 7: Raport vjetor i NjsBC 2023-2024 (rezultatet e pyetësorit të studentëve) Evidenca 18: Pyetësorët për studentët dhe pedagogët Evidenca 30: Raport vjetor i DSLT 2023-2024 Evidenca 14: Rregullore e ZSKK (Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës) Evidenca 9: Performanca shkencore e KUB

Konkluzione

- KUB ka hartuar dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme, për sigurimin e cilësisë së Institucionit dhe të programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.
- Institucioni përdor tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

(Signature)

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Sipas RVB, dokumentave në DVV rezulton se programi TLE është organizuar që të harmonizojë të gjithë komponentet duke përfshirë lëndë me përmbajtje teorike bazë (disiplina të formimit të përgjithshëm, si fizikë, matematikë teknike, etj), lëndë të formimit karakterizues të programit, disiplina integruese dhe të zgjedhura dhe veprimtari plotësuese të karakterit formues. GVJ mbështetur në dokumentacionin DVV konstaton se Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” është i organizuar në lëndë/module dhe aktivitete formuese, leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyra kursi, të vlerësuara me kredite dhe të ndara në dy vite akademike, 4 semestra, me 120 kredite (ECTS) në total. Kategoritë e veprimtarive formuese janë në përputhje me VKM 879/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41/2018”, Tabela 1.1: • Kategoria A-Lëndë bazë 15%; gjithsej 3 lëndë – sipas VKM 10-15% • Kategoria B-Lëndë karakterizuese 52%; gjithsej 12 lëndë – sipas VKM 45-55% • Kategoria C-Lëndë ndërdisiplinore/integruese/ grup-lëndë me zgjedhje 13%; gjithsej 4 lëndë/module, ku studenti mund të zgjedhë njëren nga 2 prej tyre – sipas VKM duhet 5-15% • Kategoria D-Lëndë plotësuese 15%; gjithsej 2 lëndë + 2 praktika profesionale – sipas VKM duhet 10-15%, • Kategoria E-Detyrime përmbyllëse 5%, - Mbrojtje diplome – sipas VKM duhet 3-5%. Evidencat 10 + 23: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë) Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 10 Plani mësimor Evidenca 61 Format tip syllabusi SYLLABUSET e programit të studimit TLE

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.	Programet e studimeve të larta profesionale 2 vjeçare në KSLP kanë si objektiv të krijojnë profesionistë të lartë, që t'u përgjigjen kërkesave dhe nevojave të tregut të punës brenda dhe jashtë vendit. Në Nenin 3 të Rregullores së programit të studimit përcaktohen "Qëllimi dhe objektivat e programit të studimit", të cilat të detajuara në pikën 6 shkruhen, [cit]: <i>misioni është që këta teknikë të përgatitur me këtë kurrikul fitojnë kompetenca të mund të punësohen në serviset dhe kompanitë e sisemeve kompjuterike, elektrike, motorike dhe të automjeteve si dhe në marketet e pjesëve të këmbimit dhe të kolaudimit.</i> Mbi bazën e DVV dhe intervistave me studentët, GVJ konstatoi se aplikimi në praktikë i njohurive dhe aftësive të fituara realizohet përmes laboratorëve dhe praktikave pranë subjekteve pritëse dhe nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete si klubet studentore, trajnime, pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare. Evidencat 10 + 23: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca 11: Rregullore për Praktikën Evidenca 12: Udhëzues për përgatitjen e Praktikës
Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	Sipas RVB dhe Rregullores, programi me karakter profesional 2-vjeçar "Teknik i Lartë Elektrik", me 3 profile: "Energjetikë", "Elektromekanike" e "Automatizim Industrial" është i organizuar në lëndë/module ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale në profilin e fushës elektrike. Ky program formon specialistë në fushën e instalimeve elektrike, duke i përgatitur për të punuar si: • Teknik i Lartë Elektrik në impiantet dhe linjat e prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, si operator dhe mirëmbajtës. • Teknik i Lartë Elektrik për instalimet elektrike dhe mirëmbajtjen e linjave dhe impianteve të prodhimit industrial. • Teknik i Lartë Elektrik për instalimet elektrike dhe mirëmbajtjen e tyre në ndërtesat civile. Objektivat e programit të studimit dhe mundësitë e punësimit publikohen në faqen e internetit të KUB, broshurat informuese, etj. Evidenca 3: Rregullore KUB Evidencat 10 + 23: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca: Vendimi i Senatit nr. 11 datë 30.09.2024 për miratimin e kurikulave të v.a. 2024-2026

Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ mbështetur në dokumentacione DVV konstaton se Programi i studimit me karakter profesional “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, i referohet nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet “Diplomë Profesionale” në “Teknik i Lartë Elektrik” në “Kolegjin Universitar të Biznesit”. Në Rregulloren e programit të studimit dhe në planin mësimor janë të përcaktuara ngarkesa në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse: Të gjitha lëndët/modulet janë të shprehura në kredite që janë nga 4-6 kredite. 1 kredit ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Kategoritë e veprimtarive formuese jepen në Kriterin 1, të këtij standardi, ku GVJ ka konstatuar se janë në përputhje me VKM 879/2019. Në program janë parashikuar kredite për: • Leksione 52 ECTS • Ushtrime/ Seminare 29 ECTS • Laboratorë / Praktika 20 ECTS • Praktikë profesionale 10 ECTS • Provim përfundimtar 6 ECTS GVJ mendon se kjo ndarje është pozitive, pasi krahas pjesëve teorike të leksioneve, studenti diskuton në seminare apo zgjidh ushtrime praktike, si edhe kryen vetë veprimtari praktike në laboratorët apo praktikat në teren. Evidencat 10 + 23: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë)
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë	KUB nuk ka status të veçantë.

përgjegjëse për arsimin.	
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	<i>Institucioni ka gjetur programe të ngjashme me të paktën 2 IAL në Shqipëri siç është UAMD dhe KPT.</i>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	GVJ, sipas RVB e planit mësimor konstaton se është bërë edhe kodifikimi i programit të studimit me karakter profesional TLE, mbështetur në VKM 310/2022. Kodi i këtij programi studimi është 52-PP-0713-S . Për kodifikimin e lëndëve në planin mësimor GVJ konstaton se nuk është bërë kodifikim i lëndëve. Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë) Evidenca 24: Shkresa MAS nr. 7381/19 prot., datë 30.12.2024 për kodifikimin e programeve

Konkluzione

- GVJ konstaton se programi i studimit "Teknik i Lartë Elektrik", me 3 profile: "Energjetikë", "Elektromekanike" e "Automatizim Industrial" organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, si në formë ashtu edhe në përmbajtje.
- Janë zbatuar kërkesat e Sistemit të Bolonjës, ku lëndët modulet janë shprehur në kredite/orë për kredite. Lëndët janë organizuar në disa forma mësimdhënie si: Leksione, Ushtrime, Seminare, Laboratore, Praktikë profesionale, etj.
- Institucioni ofruon programin "Teknik i Lartë Elektrik", me 3 profile: "Energjetikë", "Elektromekanike" e "Automatizim Industrial" me përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind me 2 programe që ofrohen nga 2 IAL në Shqipëri siç janë UAMD dhe KPT.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë	Bazuar në RVB, Njësia bazë përgjegjëse për programin e

(Signature) *(Signature)*

përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	studimit “Teknik i Lartë Elektrikë”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” është Departamenti i Studimeve të Larta Teknike. Ajo është Njësi bazë edhe për 2 programe të tjera 2-vjeçare. - “Teknik i Lartë Automobilah” me 3 profile: “Automekanik”, “Autotronik”, “Hibride-Elektrike” - “Teknik i Lartë” me 3 profile: “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn” dhe grupon disiplina mësimore trajnuese të përafërta. GVJ për vlerësimin e këtij kriteri ju referua të dhënave tabelore të deklaruara në DVV, nga të cilat rezultoi se: Njësia bazë DSLT plotëson kriterin ligjor të numrit total se ka në përbërje 7 PAE (numri minimal është 5), dhe plotëson numrin minimal të PAE që kanë tituj/grada sepse ka 2 PAE me titullin Prof. As. Dr. dhe 1 PAE me Gradën Dr. (numri minimal është 1)¹. Pjesa tjetër e stafit është asistent-lektor me Msc. Numri i stafit të departamentit për dy vite 7 PAE/ 9 PAK 2024-2025 7 PAE/ 12 PAK 2023-2024 KUB është institucion i akredituar me VBA nr. 3, datë 07.01.2022. Gjithashtu, është bërë akreditimi i pjesshëm institucional, me VBA nr. 53, datë 09.11.2020, për shkak të hapjes së Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale (KSLP), me urdhër të MASR nr. 139 datë 23.03.2018. Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të programit të studimit. Evidenca 60: Lista e stafit akademik KSLP Evidenca 54: Urdhër MASR nr. 319, datë 27.06.2023 (TLE) Evidenca 65: Urdhër MASR nr. 139, 23.03.2018 hapja e KSLP si njësi kryesore Evidenca 66: Vendim BA nr.3, 07.01.2022 akreditim periodik i KUB Evidenca 51: Urdhër Rektor nr. 118, datë 26.02.2025 për ngritje GVB për akreditimin të programit TLE
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e	Në RVB, dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit u deklarua se KUB dhe njësia bazë DSLT bashkërendojnë punën e tyre me stafin administrativ si stafin e sekretarisë mësimore për

¹ VKM nr. 370, datë 26.4.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit Profesional të lartë”, neni 5.



përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	realizimin sa më efikas të proceseve të ndryshme brenda departamentit. Departamenti ka në dispozicion 3 laboratorë për realizimin e punëve laboratorike dhe praktikave mësimore. Në tabelën përmbledhëse të stafit janë 3 staf ndihmës akademik (laborantët) që realizojnë lëndët dhe orët përkatëse laboratorike. Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela nr. 2 Staf i DSLT; tabela nr. 16 Infrastruktura Evidenca 69: Infrastruktura + laboratorët – Relacion mbi infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse të KUB Evidenca 71: Urdhër Rektor për emërim laborant 27.03.2025								
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Sipas RVB, GVJ konstatoi se Departamenti i Studimeve të Larta Teknike, si njësi bazë për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, për ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit dhe praktikave profesionale ka caktuar një pedagog si koordinator, person përgjegjës për ndjekjen e studentëve në praktikat profesionale. Gjithashtu për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale në mbështetje të Departamentit është dhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. GVJ nga takimet me Drejtuesin e DSLT dhe të NjBSC konstaton se në rolin e koordinatorit të programit është drejtuesi i departamentit, me shumë eksperiencë menaxhimi, që i realizon detyrat lidhur me ecurinë dhe zhvillimin e programit të studimit në përputhje me objektivat e programit të studimit TLE. Evidenca: Takimet dhe Rregulloret e Institucionit								
Konkluzione - GVJ konstaton se Kolegji Universitar i Biznesit dhe Njësia bazë, Departamenti i Studimeve të Larta Teknike, përgjegjëse për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” përmbushin plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Departamenti ka në përbërje 7 PAE nga të cilët 3 me tituj/gradë dhe 9 PAK me kualifikimin Msc. - GVJ konstaton që ka 3 personel ndihmës akademik të dedikuar përgjegjës për një apo më shumë laboratorë, për të plotësuar më mirë kërkesat e programeve profesionale, në të cilat orët praktike janë shumë të rëndësishme.									
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table><tr><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr></table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Mbështetur në DVV, RVB si dhe takimet me drejtuesit e Programit të studimit, GVJ mori të gjithë informacionet e nevojshme, për të gjithë elementët e programit të studimit: organizimin, përmbajtjen dhe strukturën e tij. DSLT mban të gjithë dokumentacionin e kurrikulës si: • Rregulloren e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”; • Planin mësimor; • Syllabuset lëndore, të cilat janë hartuar sipas modeleve të kërkuara nga aktet ligjore, përsa i përket elementeve përbërës; • Rregulloren e praktikës profesionale; • Udhëzues për praktikën profesionale; • Rregullore e provimeve, etj; Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin edhe në faqen e internetit të KUB https://kub.edu.al/studentet-2/#diplomimi Evidencat 10 + 23: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë) SYLLABUSET e programit të studimit TLE Evidenca 11: Rregullore për Praktikën Evidenca 12: Udhëzues për përgatitjen e Praktikës Evidenca 13: Rregullore e provimeve Evidenca 21: Guida e studentit
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	GVJ konstaton se Plani mësimor i programit të studimit TLE është i plotë, me të gjithë informacionin për semestrat, orët mësimore të çdo lënde/moduli, të ndarë sipas formave të mësimdhënies si dhe të ndara në orë mësimore në auditor dhe në orë të punës individuale të studentit. <i>GVJ mendon se kriteri që “Rreth 25% e programit studimi i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion” është arritur (sepse 100 orë praktikë direkt në profesion i shtohen orët e praktikës laboratorike të lëndëve të lidhur direkt me profesionin (196 orë) krahasuar me 1198 orë gjithsej në auditor - rezultojnë rreth 25%).</i>



	Evidenca shitesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë) Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 10 Plani mësimor
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Kriteret e pranimit në KUB miratohet me vendim të Senatit Akademik, depozitohen në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe publikohen rregullisht në faqen e internetit të KUB dhe në rrjetet sociale të KUB. Informacionet e plota për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve jepen në nenet 5-6, 23 të Rregullores së programit të studimit dhe në Rregulloren e ekuivalentimit të studimeve, si edhe në faqen e internetit të KUB. Pranohen për t'u regjistruar pranë KUB të gjithë ata kandidatë të cilët: 1. Kanë aplikuar në Portalin e Maturës Shtetërore dhe janë shpallur fitues në programin e përzgjedhur të studimit. 2. Vërtetojnë me dokument zyrtar mbarimin e shkollës së mesme në Shqipëri ose jashtë shtetit, së bashku me listën e notave (ekuivalentuar sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë). 3. Kryejnë pagimin e tarifës së studimit sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse mes KUB dhe studentit. 4. Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e Kontratës së studentit midis tij dhe KUB. 5. Në programet e studimit pranohen për t'u regjistruar shtetas shqiptarë ose të huaj. Në nenin 5 të Rregullores janë vendosur kriteret e përgjithshme për kandidatët që regjistrohen në këtë program studimi, [cit]: 1. Kriteri bazë për pranimin e studentëve në programin e studimeve profesionale TLE është përfundimi me sukses i arsimit të mesëm të lartë 2. Kriteret shitesë për pranimin e studentëve në programin e studimeve profesionale miratohen dhe shpallen çdo vit nga KUB. Në RVB deklarohet se: <i>Dokumentat si më lart vihen në dispozicion të studentëve dhe janë të shpalluara në ambientet e shkollës.</i> Sipas RVB, parimet e pranimit të studentëve të rinj, bazohen në kriteret e detyrueshme ligjore, kapacitetet e KUB në infrastrukturë, burimet njerëzore, analizave të tregut të punës, ecurisë së programeve dhe punësimit të studentëve. Kuotat dhe

	kriteret e pranimit shqyrtohen dhe miratohen nga Senati Akademik, para fillimit të vitit akademik, dërgohen pranë organeve përkatëse, vendosen në portalin U-Albania si dhe bëhen publike e përditësohen në faqen e internetit të KUB. (shih: https://kub.edu.al/pranimet/) Nga vizita në sekretarinë mësimore GVJ konstaton se, pranimi i studentëve bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjorë në fuqi, me aktet rregullatore dhe Statutin e KUB. Evidenca 3: Rregullorja KUB, Kreu IX Organizimi i studimeve, nenet 57-68 Evidencat 10 + 23: Rregullorja e programit të studimit TLE, nenet 5-6 https://kub.edu.al/pranimet/ Evidenca 83: Vendim SA nr. 4, datë 01.03.2025 miratimin e kuotave të pranimit për v.a. 2025-2026 Evidenca 82: Shkresa MAS me nr. 6643/2 prot., datë 02.12.2024 për verifikimin e kapaciteteve pritëse Evidenca 20 + 31: Rregullore e ekuivalentimit të studimeve
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Nga DVV dhe vizita në KUB, GVJ konstaton se, për secilën lëndë të programit të studimit janë hartuar programet lëndore (syllabuset). Ato janë hartuar në përputhje me formatet e miratuara në aktet ligjore. Në çdo syllabus ka detajet e nevojshme për kreditet/orët mësimore për leksionet, ushtrimet, orët e laboratorit, praktikat profesionale, apo detyrimet përmbyllëse, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Gjithashtu në syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Syllabuset miratohen përpara fillimit të semestrit nga drejtuesi i departamentit. SYLLABUSET e programit të studimit TLE Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë) Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 10 Plani mësimor
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në	Në kuadër të përditësimit të kurrikulave, duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut të punës në përputhje dhe me zhvillimin e teknologjisë, departamenti ka bërë ndryshime në përditësimin e syllabusve, literaturës, infrastrukturës në dispozicion apo kurrikulës sipas rregullores së brendshme dhe aktet nënligjore në fuqi. Lidhur me programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3

njësine bazë.	profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” është ofruar për herë të parë në v.a. 2023-2024 dhe në këtë vit përmbyllin studimet brezi i parë i studentëve. Evidenca 16: Vendimi i Senatit nr. 11 datë 30.09.2024 për miratimin e kurikulave të v.a. 2024-2026 Evidenca 54: Urdhëri MASR 319, 27.06.2023 hapje prog TLE
---------------	--

Konkluzione

- GVJ konstaton se Programi i studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.
- GVJ konstaton se është bërë ndarja e krediteve brenda një lënde, në leksion, seminar, ushtrime, laborator, detyrë kursi, etj.
- GVJ konstaton se kuotat dhe kriteret e përgjithshme e specifike të përcaktuara nga KUB ju bëhen të ditura kandidatëve si në U-Albania edhe në faqen zyrtare të institucionit.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	GVJ konstaton se emërtimi i lëndëve/apo veprimtarive në përgjithësi është në përputhje me përmbajtjen e temave që përmban lënda. Shpërndarja e lëndëve sipas semestrave dhe e praktikës profesionale në fund të semestrit të dytë në vitin e parë dhe të dytë, tenton drejt thellimit të njohurive dhe rritjes së kompetencave dhe aftësive profesionale të studentëve. Pra ka një shpërndarje të natyrshme të ngarkesës. Ndërthurja e njohurive teorike (leksione) me ato praktike (ushtrime, laboratorë, praktika mësimore, etj.) i jep të diplomuarit në këtë program studimi kompetenca profesionale të mjaftueshme për t’u punësuar si teknikë elektrikë të kualifikuar në tregun e punës, vendas e të huaj. SYLLABUSET e programit të studimit TLE

	Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë)														
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	GVJ konstaton se tërësia e lëndëve që përbëjnë kurrikulën synon arritjen e objektivave të programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” dhe formimin profesional të studentëve. Shpërndarja është me 30 kredite për çdo semestër, ku në semestrin e parë janë vendosur lëndët e tipologjisë A dhe D dhe një lëndë B. Ndërsa më tej vazhdojnë lëndët e tipologjisë B dhe C (si lëndë integruese e C (si lëndë me zgjedhje), praktika profesionale D dhe në fund diplomimi E. Çdo vit ka dy semestra dhe çdo semestër ka 15 javë mësimore. Shpërndarja e lëndëve është bërë e tillë që lëndët, njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që fitohen të jenë në vijimësi të njëra-tjetrës. SYLLABUSET e programit të studimit TLE Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë)														
Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga analiza e planit mësimor dhe tabelës së ndarjes së lëndëve sipas veprimtarive formuese (A-E), GVJ mendon se programi i studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” synon arritjen e objektivave nëpërmjet formimit teorik të harmonizuar me atë praktik, nëpërmjet laboratorëve, detyrave të kursit, apo praktikave dhe punëve konkrete. Sipas llogaritjeve të vetë institucionit raporti teori / praktikë është 46% me 49%. Konkretisht nga plani mësimor i programit TA rezultojnë: <table> <tr> <td>• Orë të formimit teorik (Leksion)</td><td>550 orë</td></tr> <tr> <td>• Orë të formimit teorik + praktik (Seminar)</td><td>292 orë</td></tr> <tr> <td>• Orë të formimit praktik (Ushtrime+Laborator)</td><td>196 orë</td></tr> <tr> <td>• Orë të formimit praktik (Praktikë lënd.)</td><td>36 orë</td></tr> <tr> <td>• Orë të formimit praktik (Praktikë prof.)</td><td>100 orë</td></tr> <tr> <td>• Orë të provimit përfundimtar (diplomimit)</td><td>60 orë</td></tr> <tr> <td>• Orë të formimit në auditor gjithsej</td><td>1198 orë</td></tr> </table> GVJ konstaton se raporti teori / praktikë është afërsisht 50%:50%, në përputhje me profilin e programit të studimit si një program 2-vjeçar me karakter profesional. GVJ mendon se edhe kriteri që “Rreth 25% e programit studimi i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion”	• Orë të formimit teorik (Leksion)	550 orë	• Orë të formimit teorik + praktik (Seminar)	292 orë	• Orë të formimit praktik (Ushtrime+Laborator)	196 orë	• Orë të formimit praktik (Praktikë lënd.)	36 orë	• Orë të formimit praktik (Praktikë prof.)	100 orë	• Orë të provimit përfundimtar (diplomimit)	60 orë	• Orë të formimit në auditor gjithsej	1198 orë
• Orë të formimit teorik (Leksion)	550 orë														
• Orë të formimit teorik + praktik (Seminar)	292 orë														
• Orë të formimit praktik (Ushtrime+Laborator)	196 orë														
• Orë të formimit praktik (Praktikë lënd.)	36 orë														
• Orë të formimit praktik (Praktikë prof.)	100 orë														
• Orë të provimit përfundimtar (diplomimit)	60 orë														
• Orë të formimit në auditor gjithsej	1198 orë														

	është arritur (sepse 100 orë praktikë direkt në profesion i shtohen orët e praktikës lëndore 36 orë dhe të laboratorëve 196 orë (332 orë) krahasuar me 1198 orë gjithsej në auditor - rezultojnë rreth 29%). Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë)
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ konstaton se në programin e studimit me karakter profesional në “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” ndarja sipas veprimtarive formuese, (A-E) krijojnë mundësinë për një formim të plotë të studentëve, në përputhje me objektivat formuese të tij. Ndërtimi i programit sipas parimeve të Bolonjës, u mundëson studentëve transferimin e studimeve nga dhe në institucione të tjera. KUB ka ngritur disa laboratorë ku studentët krahas njohurive teorike, realizojnë orët praktike, formohen individualisht dhe në grup për aftësitë dhe shkathtësitë që nevojiten në profesion. Nga takimet me studentët dhe me përfaqësues të Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, tregojnë kërkesa për punësim të studentëve të këtij programi studimi, ndonëse këtë vit diplomohet brezi i parë (një pjesë e studentëve janë punësuar që gjatë praktikave profesionale). <i>Krahas mundësisë për punësim studentët janë pjesë e mobiliteteve në vendet e BE-së falë projekteve europiane ku KUB merr pjesë.</i> SYLLABUSET e programit të studimit TLE Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë) Evidenca 34 + 62: Statistika të punësimit Evidenca 57: Raporti vjetor i KUB 2023-2024, fq 68-70 Panairi Work & Study, fq 38 janë 2 Mobilitete të studentëve
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.	Mbi bazën e RVB dhe DVV, GVJ konstaton se programet e lëndëve janë objekt i diskutimeve për përditësimin e tyre duke u bazuar në literaturën e detyruar dhe ndihmëse të viteve të fundit, (u deklarua se synohet literatura bashkëkohore e 5 viteve të fundit). Syllabuset rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, dhe miratohen nga Drejtuesi i departamentit. Bashkëpunimi dhe mundësia e aksesit në biblioteka online, mundëson përditësimin e vazhdueshëm të literaturës. GVJ u interesua në bibliotekë nëse literatura e rekomanduar është pjesë e bibliotekës dhe rezultoi që në të gjitha rastet ato janë në departamet, ose në bibliotekë. GVJ konstaton se krijimi i bibliotekës on-line, mobiliteti i stafit

	akademik në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, kanë reflektuar edhe në punën për përmirësimin e syllabuseve. SYLLABUSET e programit të studimit TLE https://kub.edu.al/erasmus/ https://kub.edu.al/projekte/ Evidenca 35: Raport i veprimtarisë shkencore staf akad 2019-2024
Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	GVJ konstaton se bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, është saksionuar në Rregulloren e programit të studimit TLE. Zhvillimi i praktikës bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Praktikave Profesionale, e sipas dokumentacioneve shoqëruese për të. Nga DVV GVJ evidenton se është paraqitur tabela me marrëveshjet me punëdhënësit, ku studentët bëjnë praktikën. Në KUB funksionon sistemi i tutoratit ku pedagogët ndihmojnë studentët, në qartësimin e ideve, i ndihmojnë të kapërcejnë vështirësitë që paraqet arsimi i lartë, dhe i inkurajojnë që të përfitojnë nga mundësitë për punësim. Evidenca 11: Rregullorja për praktikën profesionale në KSLP Evidenca 12: Udhëzues për praktikën profesionale Evidenca 13: Rregullore e provimeve Evidenca 21: Guida e studentit Evidenca 8: Lista e marrëveshjeve për praktikat 2023-2025 (tabela nr. 5 tek tabelat përmbledhëse 1-24) Evidenca 17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KUB
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	Përmbajtja e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Automatizim Industrial” e “Elektromekanike” u mundëson dhe u garanton studentëve përfitimin e dijeve, fitimin e aftësive dhe kompetencave profesionale, të cilat përbëjnë edhe synimet kryesore të këtij programi, që synon formimin e teknikëve të lartë në fushën elektrike. Kompetencat e synuara të të diplomuarve janë: njohuri dhe përgatitje e teknikëve elektrikë të destinuar për të punuar kryesisht në kompani energjitike të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, ndërmarje industriale, instalime elektrike në ndërtesa, për panelet fotovoltaike e eolike, në pajisje automatike të prodhimit e shërbimit, etj. Nga takimet me studentët GVJ konstatoi se një pjesë e tyre janë të punësuar “part time” në orare të cilat nuk pengojnë në vazhdimin dhe realizimin e procesit mësimor për ta. Gjithashtu si pjesë e praktikave organizohen vizita në terren të studentëve

	në shoqërimin dhe mbikqyrjen e pedagogëve të ndryshëm në biznese, industri, për të parë nga afër, njohur dhe familiarizuar me procese pune, procedura etj si dhe me vetë ambientin dhe kulturën e punës. KUB ka në organigramën e saj Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës që ndjek edhe të dhënat për punësimin e studentëve si një tregues i performancës së programit të studimit në treg. Nga takimi me përfaqësues të kësaj zyre GVJ mësoi se aty mbahet një databazë të dhënash për punësimin pas studimeve (sipas vetëdeklarimit të tyre), apo i jepet informacion këshillim karriere për punësimin e tyre. Evidenca 34 + 62: Statistika të punësimit
--	---

Konkluzione

- GVJ konstaton se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit "Teknik i Lartë Elektrik", me 3 profile: "Energjetikë", "Automatizim Industrial" e "Elektromekanike" është në përputhje me objektivat formuese të synuara dhe me nivelin 5 të KSHK.
 - Rezultatet e të nxënit, kompetencat e fituara në përgjithësi janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
 - GVJ konstaton se raporti teori / praktikë është afërsisht 50% : 50%, në përputhje me profilin e programit të studimit, duke plotësuar kërkesën e kriterit si një program 2- vjeçar me karakter profesional.
- GVJ mendon se kriteri që "Rreth 25% e programit i dedikohet aftësisimit në praktikë/punë konkrete në profesion" është arritur dhe rezulton rreth 29%.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të	Nga takimet me drejtuesit, GVJ konstatoi se KUB është anëtar në disa projekte me partnerë të brendshëm dhe të jashtëm (universitete) ku në qendër është cilësia dhe studentët. Për këtë program studimi janë disa marrëveshje me aktorë të tregut të punës, ku krahas kryerjes së praktikave profesionale, ato shërbejnë edhe për përmirësimin e përmbajtjes së programit

(Signature)

studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	të studimit. Nga DVV dhe RVB del se DSLT për të vlerësuar nivelin dhe mundësinë e ndryshimit të programit ka ngritur Bordin e Këshillimit të Karrierës i cili përfshin përfaqësues nga institucionet partnere dhe studentë të diplomuar, me synim azhornimin e programit me kërkesat e tregut të punës. Kolegji Universitar i Biznesit është i përfshirë në projektet: ❖ Erasmus + KA1: Mobility for learners and staff in adult education Capacity building in Higher Education (CBHE); ❖ Erasmus + Ka2: Vocational education and training (VET). Në komponentin KA2 (Capacity Building in Higher Education), me anë të projekteve fituese Kolegji Universitar i Biznesit ka si qëllim të modernizojnë metodat e mësimdhënies, të krijojë programe të reja studimi ose të përmirësojnë programet ekzistuese duke i harmonizuar me ato të vendeve të zhvilluara të BE-së, të trajnojnë stafet akademike, të përmirësojnë laboratorët, të krijojë ose të përmirësojnë shërbimet për studentët, për sigurimin e brendshëm të cilësisë, etj. Evidenca 26: Studim tregu Evidenca 32: Vendimi i departamentit të DSLT, mbi ngritjen dhe funksionimin e Bordit të Këshillimit të Karrierës https://kub.edu.al/erasmus/ https://kub.edu.al/projekte/
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	GVJ në takimet me studentët dhe drejtuesit e departamentit u informua se KUB/DSLIT ka përfshirë studentët në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit në formën që çdo personel akademik me detyrë tutor, në fund të semestrit mbledh mendime/ sugjerime nga studentët. Këto i parashtron në mbledhjen e posaçme të departamentit. Përfshirja e studentit, si anëtar i GVB është bërë me urdhër të Rektorit, si pjesë e këtij angazhimi. Në bazë të DVV, GVJ konstatoi se KUB në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar, ku në qendër janë shqetësimi për kënaqësinë e tyre për programin, mjetet laboratorike etj. Përfundimet e nxjerra e vlerësimet ndihmojnë në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Projektet në kuadrin e komponentit KA2 të programit Erasmus+

	për kapacitetin e ndërtimit në arsimin e lartë (Capacity Building in Higher Education) janë të ndihmuara financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe kanë si qëllim të përmirësojnë cilësinë dhe kapacitetin e institucioneve të arsimit të lartë në vendet jashtë BE-së. Bazuar në RVB dhe konstatimet nga takimet e zhvilluara, Kolegji Universitar i Biznesit mund të përfitojë nga ky program për të zhvilluar dhe modernizuar sektorin e tyre të arsimit të lartë. Evidenca 18: Pyetësorët nga NjSBC për studentë dhe pedagogë Evidenca 17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KUB
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	DSLIT si njësia përgjegjëse për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, ashtu si edhe për programet e tjera ka punuar për përmirësimin dhe përshtatjen me zhvillimet e fundit në fushën elektrike. Sipas RVB e DVV, GVJ konstaton se KUB, me anë të pjesëmarrjes në projekte, evente, studimeve të tregut, kontaktet intensive me biznesin, synon të jetë i azhurnuar me dinamikën e trendeve ekonomike, sociale dhe kërkesat e tregut të punës, në mënyrë që të reflektojë këto përkatësisht edhe në ofertën e tij akademike. Evidenca 85: Raport i Konferencave dhe konkurseve studentore 2020-2025

Konkluzione

- KUB dhe DSLIT në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit nxisin përfshirjen e studentëve, atyre alumni si dhe partnerëve.
- GVJ konstaton se programet janë përmirësuar edhe me ndryshimet e ardhura si rezultat i projekteve të BE, ku KUB dhe DSLIT janë bashkëpunëtorë.
- GVJ rekomandon të bëhet studim tregu më i detajuar për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Automatizim Industrial” e “Elektromekanike”.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

(Signature) *(Signature)*

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	GVJ, bazuar në planin mësimor të programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, për vitin 2023-2025, konstaton se në program janë parashikuar orë mësimore në auditor /jashtë auditorit, për elementët e studimit: • Leksione 514 orë mësimore • Seminar 292 orë mësimore • Ushtrime/Laboratorë 196 orë mësimore • Praktikë në auditor 36 orë mësimore • Praktikë profesionale 100 orë mësimore • Provim diplomimi 60 orë mësimore • Orë jashtë auditorit 1802 orë (orë studimi individual) Praktika profesionale I + II zhvillohet për 100 orë (<i>pas procesit mësimor dhe zgjat 3 javë</i>) pranë organizatave, kompanive dhe bizneseve me të cilat KUB ka akt marrëveshje për bashkëpunim. Mendojmë se format e ndryshme të mësimdhënies e rrisin cilësinë e këtij programi studimi. Sipas RVB dhe rregullores së programit, frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 50% për leksionet dhe 75% për seminarët, laboratorët e praktikatat. Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë) Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca 11: Rregullore e praktikës profesionale Evidenca 89: Plani i masave KUB 2024-2025
Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e	GVJ konstatoi se personeli akademik në përgjithësi i përgjigjen cilësisht nevojave të studentëve. Në syllabuse janë parashikuar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. GVJ në takimin me personelin akademik konstatoi se për plotësimin e nevojave shtesë të studentëve bëhen edhe konsultime. Në procesin e mësimdhënies përdoren edhe mjetet audio vizive për seminare të veçanta apo seanca praktike shtesë. Në platformën online Google Education të KUB ngarkohen

mësimnxënies.	materiale edukative në lidhje me lëndët mësimore (video, leksione, ushtrime të zgjidhura, ushtrime të pazgjidhura, etj) si një formë interaktive dhe moderne në ndarjen e informacionit dhe mësimdhënies. Stafi akademik synon në drejtim të asimilimit të informacionit teorik edhe përmes zbatimit të saj në praktikë. Rektorati ka ngritur struktura përkatëse-tutoratin, që përkujdeset për mbarëvajtjen e tërë procesit mësimor. SYLLABUSET e programit të studimit TLE Evidenca 48: Udhëzues për Platformën online Google Education
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	GVJ konstatoi se për të mundur përdorimin e metodave të shumëllojshme pedagogjike, Departamenti DSLT/institucioni KUB ka vepruar si në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditorë, laboratorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies, etj; ashtu edhe nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme të stafit akademik në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit për të përsosur metodat e mësimdhënies. Nga takimet me drejtuesit deklarohet se KUB është i përkushtuar që të krijojë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e kërkimit shkencor, duke përfshirë këtu përgatitjen e infrastrukturës dhe trajnimit të stafit akademik. Për të arritur këtë objektiv, KUB ka investuar dhe është në investim të vazhdueshëm në disa drejtime si: • Trajnimi i stafit dhe i burimeve njerëzore të nevojshme nëpërmjet investimit për kualifikimin e vazhdueshëm profesional dhe pedagogjik. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet angazhimit të stafit në konferenca, trajnime, studime pasuniversitare dhe doktoraturë, specializime brenda dhe jashtë vendit; • Ngritja e infrastrukturës shkencore ku mund të zhvillohet kërkimi shkencor. Aktualisht, KUB ka një bibliotekë me një numër të konsiderueshëm vëllimesh, tekstesh akademike dhe shkencore të botuara nga shtëpi botuese prestigjioze si dhe revista shkencore ndërkombëtare Për forma inovative të mësimdhënies apo për përdorimin e laboratorëve ofrohen trajnime për stafin nga KUB, edhe nëpërmjet zyrës së IT apo ofruesve të pajisjeve apo projekteve. Evidenca 64: Plani veprimtarisë shkencore për stafin Evidenca 86: Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NjSBC Evidenca 87: Vendim BA financim artikuj të stafit akademik Evidenca 63: Udhëzues për përdorim Portali elektronik KUB
Kriteri 4. Personeli	GVJ konstatoi se: Stafi Akademik në KUB është fryt i një

akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	përzgjedhje të kujdesshme, sipas standardeve më të larta akademike dhe intelektuale. Në KUB gjejmë pedagogë me tituj dhe grada shkencore, profesorë që dinë të edukojnë brezat me dijet, me etikën, sjelljen dhe kulturën më të mirë qytetare, si dhe nga ana tjetër personalitete të fushave të ndryshme, të cilët hartojnë dhe drejtojnë me kompetencë të lartë reformat në vendin tonë. GVJ, mbështetur në DVV për punën shkencore të personelit akademik, në takimet me anëtarë të tij, si dhe në takimet me studentë konstatoi përgjegjshmëri dhe një staf që punon i angazhuar për dhënien e njohurive si dhe për zhvillimin e lëndëve me cilësi. Personeli akademik i kushton rëndësi formave interaktive për të angazhuar sa më shumë studentët, ashtu si dhe puna individuale dhe ajo në grup. KUB nxit organizimin e orëve të hapura si një formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie. Evidenca 80: Kontratë pune staf akademik Evidenca 73: Listë me lex të hapura Evidenca 45: Monografi Prof. Shpëtim Cami Evidenca 9: Performanca shkencore e KUB 2019-2024 Evidenca 85: Raport i Konferencave dhe konkurseve studentore 2020-2025
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	GVJ evidenton se: Departamenti i Studimeve të Larta Teknike, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, vlerëson e përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike. Departamenti i Studimeve të Larta Teknike, si njësia bazë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve përdor edhe metoda të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar. GVJ mendon se ky proces është pozitiv dhe të dy palët rritin përgjegjshmërinë, si pedagogët, por edhe studentët. Evidenca 38: Rregullore e departamentit DSLT Evidenca 86: Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NjSBC Evidenca 89: Plani i masave KUB 2024-2025 Evidenca 3: Rregullore e KUB, nenet 5/1-5/2; 20, 21, 21/1 Evidenca 14: Rregullore e ZSKK (Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës)



Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	GVJ, mbështetur në RVB e DVV, evidenton se është ngritur Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), si njësi autonome operative e përhershme në strukturën organizative të KUB. Sigurimi i brendshëm i cilësisë garanton cilësinë e veprimtarisë së institucionit, që ajo të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore dhe në të njëjtën kohë në përputhje me vizionin, misionin dhe objektivat e KUB. GVJ konstaton se NjBSC vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore, formuese e trajnuese, si dhe të veprimtarisë administrative e financiare të KUB si dhe propozon ndryshime për përmirësimet e nevojshme. Për ushtrimin e funksioneve të saj, NjBSC-ja ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Njësia përbëhet nga Kryetari, nga 2 anëtarë pedagogë, personelin ndihmës – akademik ose administrativ, një përfaqësues nga jashtë institucionit si ekspert për çështje të vlerësimit, si dhe një anëtar përfaqësues nga studentët. Zyra e Koordinimit dhe Zyra e Kurrikulave luajnë një rol të rëndësishëm në këto procese. Evidenca 6: Rregullore e NjSBC Evidenca 7: Raport vjetor i NjSBC 2023-2024 (rezultatet e pyetësorit të studentëve) Evidenca 18: Pyetësorët për studentët dhe pedagogët Evidenca 30: Raport vjetor i DSLT 2023-2024 Evidenca 3: Rregullore e KUB, nenet 33 e 34			
Konkluzione				
<i>GVJ konstaton se KUB dhe DSLT punojnë për të garantuar:</i> <i>• cilësi në procesin e të nxënies, nëpërmjet organizimit të mësimdhënies me forma të larmishme të mësimdhënies si: leksione, ushtrime, laboratorë, detyra, praktikë profesionale, etj. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 50% për leksionet dhe 75% për seminare, laboratore, praktika.</i> <i>• aftësimin profesional të personelit akademik që zbaton metodat mësimdhënëse me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve pozitive.</i> <i>• Monitorimin e proceseve të mësimdhënies dhe promovimin nga strukturat përgjegjëse që ngrihen nga DSLT në bashkëpunim me Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë. Rezultatet janë objekt i diskutimeve dhe vlerësimeve nga studentët.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

(Signature)

(Signature)

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në: - Rregulloren e KUB, në të cilën përcaktohen rregullat e provimeve, rregullat për ankimimin e notave, etj; - Rregulloren e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”; - Syllabuset e lëndëve, ku në një rubrikë të caktuar ka të detyrueshme edhe mënyrën e vlerësimit të njohurive; - Rregulloren e sekretarisë (që sqarojnë rregullat për regjistrimet në provime, riprovime etj); Të gjitha rregullat bëhen publike dhe njihen nga studentët. KUB mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse. Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca 11: Rregullorja e praktikave profesionale Evidenca 13: Rregullore e provimeve Evidenca 78: Rregullore e sekretarisë Evidenca 27: Struktura akademike
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga intervista me studentët, [takim me studentët, takim me stafin akademik] nga RVB si dhe dosja VV, konstatohet se studentët marrin informacione të plota për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset nga titullari i lëndës/ modulit. Informimi bëhet në fillim të vitit të parë dhe në fillim të çdo lënde/ moduli. Syllabusi i lëndës dhe materialet mësimore gjenden në rubrikën e pedagogut, në portalin e KUB. GVJ konstatoi se ky informacion gjendet dhe fizikisht në ambientet e shkollës. Informacioni sqarohet edhe gjatë Javës orientuese të fillimit të vitit akademik si dhe nga çdo pedagog për lëndën e tij përkatësisht. SYLLABUSET e programit të studimit TLE Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca 21: Guida e studentit

	Evidenca 13: Rregullore e provimeve Evidenca 78: Rregullore e sekretarisë https://portal.kub.edu.al/wp-admin/post-new.php?post_type=lende			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	Nga rregullorja e programit të studimit, rregullorja e KUB, rezulton se vlerësimi për lëndët mësimore bëhet përmes sistemit të notave nga 5 (note kaluese) deri në 10, ndërsa vlerësimi i provimeve bëhet me sistemin e vlerësimit me 100 pikë, ku vlera përkatëse konvertohet në notë. Nota kaluese më e ulët që është 5 i korrespondon 41% të pikëve të fituara nga studenti. Vlerësimi i përgatitjes së studentit bëhet gjatë gjithë semestrit dhe është rezultat i kombinimit të elementeve të mëposhtëm: • Provimi përfundimtar 60 % • Teste/Detyra kursi/Laboratorë 20% • Aktivizimi në seminare/ushtrime 10% • Pjesëmarrje (frekuentim) 10%. Në lidhje me praktikën profesionale, në përfundim të saj, studenti përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojën në subjektin pritës, sipas dokumentacionit të përcaktuar në Rregulloren e praktikave profesionale, që mbrohet para një komisioni <i>ad hoc</i>. Vlerësimi i studentit për praktikën është rezultat i kombinimit të elementeve të mëposhtëm: • Kontrolli përfundimtar 40 % • Vlerësimi nga pedagogu që ndjek praktikën 20% • Vlerësimi nga kompania/servisi 40% (ku 20% - frekuentimi e disiplina + 20% aktivizimi në punë). Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE, neni 13 Evidenca 13: Rregullore e provimeve, Kreu IV Evidenca 11: Rregullorja për praktikën profesionale në KSLP, neni 7			
Konkluzione				
- GJVJ konkludon se KUB dhe DSLT kanë hartuar a) rregulloren e programit të studimit TLE, b) rregulloren e sekretarisë, c) rregulloren e provimeve, d) rregulloren e zhvillimit të praktikës profesionale si dhe e) syllabuset, ku përcaktohen procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. - Gjatë vizitës GJVJ konstatoi se KUB garanton zbatimin e tyre.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Siç është shkruar edhe më lart, testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve. Kombinimi dhe pesha e këtyre komponentëve mund të ndryshohet në lëndë të caktuara, për t'iu përshtatur më mirë natyrës së lëndës. Shkalla e përvetësimit të dijeve, me shkrim dhe/ose me gojë, vlerësohet me pikë nga 0-100 pikë dhe rezultati përfundimtar konvertohet në notë nga 4 (katër) në 10 (dhjetë). Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE, neni 13 Evidenca 13: Regullore e provimeve, Kreu III
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në RVB theksohet që: Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në sekretarinë mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Evidenca 13: Regullore e provimeve, Kreu III
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga personeli akademik i lëndës në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi këtë në procesverbalet e paraqitura. SYLLABUSET e programit të studimit TLE Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca 13: Regullore e provimeve
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të	GVJ konstaton se vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me takime me studentët ku jepen komente dhe këshilla mbi procesin e të nxënës, për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Staf i akademik mund të kryejë seanca sqaruese, pasi rezultatet të jenë bërë publike nga njësia e sekretarisë mësimore. Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE

ardhmen.	
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	GVJ konstatoi që njësitë përgjegjëse kanë treguar seriozitet për plagjiaturën, kopjimin etj. Sipas RVB dhe rregullores së provimeve, neni 15 [cit]: – <i>Studentit, gjatë kohës së zhvillimit të provimit, në mënyrë kategorike, i ndalohet të komunikojë me studentët e tjerë apo dhe me pedagogun.....</i> – <i>Studentit në mënyrë kategorike nuk i lejohet të përdorë në sallën e provimit mjete të ndryshme lidhje-komunikimit si telefona celularë, kufje, etj.</i> – <i>Studentit nuk i lejohet që të lërë të ekspozuara shënimet e tij në përgjigjet e dhëna rreth tezës së provimit, që ato të mund të lexohen nga studentët e tjerë.</i> – <i>Studentit nuk i lejohet që të tentojë të lexojë materialet e shkruara/përgjigjet e studentëve të tjerë.</i> – <i>studentit nuk i lejohet të kopjojë në çfarëdo lloj forme apo mënyre. Nëse ai tenton të bëjë një veprim të tillë, pedagogu e nxjerr jashtë nga provimi studentin dhe vlerësimi i tij është negativ.</i> Evidenca 13: Rregullore e provimeve, neni 15
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Siç citohet edhe në Rregulloren e provimeve: • Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 1 (një) jave nga data e zhvillimit të tyre. • Për studentin, që nuk merr pjesë në provimin përfundimtar të lëndës, ai vlerësohet me notë negative. • Në javën e fundit pedagogu ju komunikon studentëve pikët e fituara gjatë semestrit (frekuentim, aktivizim, detyrë, testim, etj) dhe në fund të procesit mësimor dorëzon në sekretari formularin e vlerësimit të vazhduar për komponentët e tjerë (pikët e fituara nga studenti gjatë semestrit). Evidenca 13: Rregullore e provimeve, neni 10-13
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ konstaton se KUB dhe DSLT, garantojnë të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, rishikimin e vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Në Rregulloren e provimeve parashikohet e drejta e ankimit / apelit të studentit. Në rast se studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në provimin përfundimtar, pasi ka konsumuar procedurën

	e sqarimit me pedagogun e lëndës, ai mund t'i drejtojë sekretarisë një kërkesë me shkrim brenda 5 ditëve, ku të parashtrijë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Sekretaria ja drejton kërkesat departamentit për shqyrtim. Departamenti ngre një komision për shqyrtimin e kërkesave dhe vlerësimin e tij komisioni e dorëzon në sekretari, e cila ja komunikon studentit. Evidenca 13: Rregullore e provimeve, Kreu V, neni 16
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në vazhdim të kriterit më lart, GVJ konstatoi se për çdo kërkesë/ankimim ndiqet kjo procedurë: Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. <i>Në KUB ka një kuti të kuqe ku studentët mund të shprehin opinionet e ndryshme, por edhe për vlerësimin e tyre në provim.</i> Evidenca 13: Rregullore e provimeve, Kreu V, neni 16 Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE, nenet 16-17 Evidenca 38: Rregullore DSLT, neni 31 Provimi dhe kontrolli i dijeve

Konkluzione

KUB/DSLTL dhe pedagogët synojnë të sigurojnë që:

- *Vlerësimi i studentëve të jetë i drejtë dhe transparent për provimet apo çdo formë mësimdhënie.*
- *Vlerësimi të bazohet në meritën e çdo studenti, duke luftuar vjedhjen, plagjaturën, kopjimin.*
- *Çdo student të ketë të drejtë edhe procesin e ankimit, sipas një procedure të përcaktuar dhe të njohur më herët prej tyre.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit	Mbështetur në dosjen e vetëvlerësimit, në takimin me studentët

(Signature)

duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ kostaton se kurrikula e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” garanton marrjen e njohurive në lëndë bazë (Matematikë teknike, Fizikë, Vizatim teknik dhe Autocad), si dhe zhvillimin e aftësive të veçanta për specialistë të fushës elektrike në industri, në transmetim-shpërndarje të energjisë, në instalime në ndërtesa, etj. Ndarja në orë teorike dhe praktike forcon marrjen e shprehive dhe kompetencave në proceset e mësipërme. <i>GVJ mendon se thellimi i njohurive realizohet edhe nëpërmjet laboratorëve dhe punës në orët e praktikës profesionale.</i> SYLLABUSET e programit të studimit TLE Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë) Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Në kuadër të formimit të profesionistit që duhet të ketë aftësi edhe në fusha si teknologjia, në fushat sociale dhe të komunikimit, GVJ analizoi lëndët dhe syllabuset e tyre. GVJ konstatoi se kurrikula e programit të studimit dhe veçanërisht lëndët: Anglisht, Shkenca kompjuterike, Administrim ndërmarrje ose Ekonomi biznesi synojnë të garantojnë njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit. SYLLABUSET e programit të studimit TLE Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimet me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për detyrimet përmbyllëse. SYLLABUSET e programit të studimit TLE
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli	Mësimdhënia realizohet në kombinim të orëve teorike si dhe orëve praktike, në laboratorët për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” (në ambientet e godinës 2 të KUB). Organizimi i punëve laboratorike bëhet në grupe 10-12 studentë, ku postet e punës janë të dedikuara për çdo student.



akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Realizimi i praktikave profesionale garantohej nga marrëveshjet bashkëpunuese që KUB ka nënshkruar me punëdhënësit e aktorët e biznesit siç janë: “OSHE operator”, “OSHE Dr rajonale”, “KESH HEC Fierzë”, “Rajoni Përfundim OSHE”, “Edil – Al-It sh.p.k.”, “Brika Elektrik”, “S.P.A.K. EL ssh.p.k.”, etj. Praktikave profesionale të zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në formatin përkatës, që shoqërohet me vlerësim. Kolegji Universitar i Biznesit synon për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve. KUB bashkëpunon me disa IAL në fushat akademike me interes të përbashkët (shkëmbim stafi akademik, personel administrativ, shkëmbim studentësh, shkëmbim të materialeve akademike etj). KUB ka marrëveshje edhe bashkëpunime në nivel rajonal në Europë, si dhe është pjesë e projekteve europiane. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se studentët falë projekteve ju është bërë e mundur zhvillimi i praktikave në skema mobiliteti, erasmus, etj. Evidenca 69: Infrastruktura + laboratorët – Relacion mbi infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse të KUB Evidenca 8: Lista e marrëveshjeve për praktikave 2023-2025 (tabela nr. 5 tek tabelat përmbledhëse 1-24) Evidenca 17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KUB
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në RVB deklarohet se personeli akademik, efektiv dhe me kontratë zhvillon leksione, orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të teknologjisë dhe shkencës dhe për t’ju shërbyer studentëve me shembuj të praktikave të suksesshme. Veprimtaritë dhe trajnimet ekstra kurrikulare për studentët janë pjesë përbërëse integrale e portofolit të KUB. KUB prezanton risitë në fushat e ndryshme të industrisë apo teknologjisë, duke organizuar takime të ndryshme në mjedise teknologjike siç mund të jenë: vizita në kompani, sektorë industrialë apo biznese lokale. Evidenca 73: Listë me leksione të hapura
Konkluzione - GVJ vlerëson se programi i studimit profesional “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” synon të rrisë aftësitë krijuese dhe zbatuese tek studentët dhe veprimtaritë mësimore jashtë auditorit synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ata. - Realizimi i praktikave profesionale garantohej nga laboratorët e KUB si edhe marrëveshjet bashkëpunuese që KUB, ka nënshkruar me punëdhënësit e aktorët e biznesit. - Veprimtaritë dhe trajnimet ekstra kurrikulare për studentët janë pjesë përbërëse integrale e	

portofolit të KUB. KUB prezanton risitë në fushat e ndryshme të industrisë apo teknologjisë.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	GVJ evidenton se në Rregulloren e departamentit DSLT, të programit të studimit TLE dhe të provimeve, të cilat janë publike, specifikohen qartë detyrimet përmbyllëse që ka studenti. Nga takimi me drejtuesit dhe studentët e programit u deklaruar se me detyrimet përmbyllëse studentët njihen paraprakisht nëpërmjet email-eve. Detyrimet për çdo lëndë jepen në çdo syllabus, në mënyrë që studenti të përgatisë materialet që duhet të dorëzojë, si punime të punëve të laboratorëve, detyra kursi, mbrojtja e praktikës profesionale. Detyrimi përmbyllës është provim i përgjithshëm përfundimtar. Evidenca 37: Rregullorja KSLP, kreu IX Diplomimi, neni 53 Evidenca 38: Rregullorja e DSLT, neni 33 Provimi i diplomimit Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE Evidenca 40: Rregullore e diplomimeve, Urdhër Rektor Evidenca 41: Udhëzim për mbrojtje diplome Evidenca 11: Rregullorja e praktikave profesionale SYLLABUSET e programit të studimit TLE
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Nga takimi me stafin dhe drejtuesit u konstatua se Stafi akademik në bashkëpunim me sekretarinë organizojnë konsultime para provimeve, takime sqaruese me studentët informacione që lidhen me dorëzimin e punëve laboratorike dhe instruksione për dorëzimin e dosjes së praktikës profesionale. Kjo procedurë bëhet duke përcaktuar oraret. Ndërkohë, procesi i praktikave profesionale ndiqet nga një koordinator, një pedagog për të 3 profilet e programit të studimit. Strukturat përkatëse të cituara më lart, asistojnë studentët, edhe në funksion të provimit përfundimtar të diplomimit. Evidenca 40: Rregullore e diplomimeve, Urdhër Rektor Evidenca 41: Udhëzim për mbrojtje diplome Evidenca 11: Rregullorja e praktikave profesionale

(Signature)

Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	GVJ konstaton se, gjatë përgatitjes së procesit të zhvillimit të provimit përfundimtar, Departamenti DSLT, bazuar në rregulloren e programit të studimit TLE, evidenton kategoritë e lëndëve themeltare që duhet të përmbajë provimi përfundimtar. Në bashkëpunim me stafin akademik, përgjegjës për mbulimin e këtyre lëndëve, hartojnë dhe miratojnë përmbajtjen e pyetjeve të testit. Provimi përfundimtar është i ndërtuar nga një databaze pyetjesh për lëndët që janë më përcaktuese për profesionin e studentëve. Pësia e secilës lëndë në provimin përfundimtar përcaktohet me përqindje dhe total pikësh të përcaktuara për çdo grup pyetjesh. Evidenca 40: Rregullore e diplomimeve, Urdhër Rektor Evidenca 41: Udhëzim për mbrojtje diplome Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	GVJ konstaton në planin mësimor të programit të studimit si detyrim përmbyllës provim formimi, me 6 ECTS. Në planin mësimor janë deklaruar 60 orë në auditor (për konsultime etj). Për studentët e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, si program 2-vjeçar detyrimi përmbyllës është me provimin të përgjithshëm përfundimtar. Evidenca shtesë: Dosje programi (Plani mësimor + veprimtaritë) Evidenca 37: Rregullorja KSLP, kreu IX Diplomimi, neni 53 Evidenca 38: Rregullorja e DSLT, neni 33 Provimi i diplomimit Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	N/A Nuk ka patur tema diplome të mbrojtura nga studentët, për vitin 2024-2025.
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	GVJ konstaton se Rregullorja e KUB ka të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes. Provimi përfundimtar dhe punimi i diplomës vlerësohen me notë. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal. Evidenca 37: Rregullorja KSLP, kreu VII Kontrolli i dijeve, neni 47 Evidenca 38: Rregullorja e DSLT, nenet 31-34

	Evidenca 10: Rregullorja e programit të studimit TLE, neni 18 Evidenca 40: Rregullore e diplomimeve, Urdhër Rektor Evidenca 41: Udhëzim për mbrojtje diplome
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	GVJ nga DVV evidenton se programi 2-vjeçar i studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, realizohen me 120 kredite. Kohëzgjatja normale është 2 vite akademike (4 semestra) dhe në përfundim të tyre do të lëshohet “Diplomë Profesionale” në fushën e arsimimit të kryer. Pas përfundimit të studimeve, studenti ka të drejtë të kërkojë të marrë një kopje zyrtare të kurrikulës (Lista e notave, planit mësimor, syllabuseve) të programit të studimit të zhvilluar. Studentët pajisen përkatësisht me numër matrikulli nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (sipas ligjit 80/2015, neni 91). EvidencaMiratimi i modelit të Diplomës Evidenca 77/1: Format Diplome, suplement diplome
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	GVJ konstatoi se: KUB mbledh, ruan dhe përpunon të dhënat personale të studentëve në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna regjistrohen dhe ruhen në regjistrat përkatës dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të KUB – Edu for school. Në lidhje me ecurinë e studentëve KUB zbaton legjislacionin duke hedhur të dhënat në Regjistrin Themeltar, Regjistrin e arritjeve akademike dhe Regjistrin e Diplomave. KUB ruan për një periudhë të pacaktuar (përgjithmonë) kopje të dokumentacionit të studentit. KUB disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit. Evidenca 2: Statuti KUB, neni 77 - Sekretaria mësimore neni 78 - Dokumentacioni i procesit mesimor Evidenca 78: Rregullore e sekretarisë mësimore
Konkluzione - GVJ konstaton se KUB ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. - Në rregullore janë të përcaktuara të gjitha hapat për provimin përfundimtar, që nga lëndët që përfshihen, hartimi i tezave, korigjimi i provimeve, procedura e ankimimit, etj. - Në përfundim të studimeve studenti pajiset me Diplomë Profesionale: “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” dhe	

Suplementin e Diplomës.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Një udhëzues është hartuar në rang institucioni gjatë periudhës së Pandemisë së Covid-19, kur mësimi u zhvillua online - Udhëzuesin për përdorimin e Google Education. GVJ konstatoi nga RVB dhe takimet me drejtuesit dhe stafin se: [cit] <i>Janë zhvilluar mësimet të hapura prej të cilëve nga diskutimet janë unifikuar shumë aspekte të ndërtimit të orës mësimore apo të mënyrës së kontrollit e vlerësimit të dijeve, të mënyrës së prezantimit dhe të diskutimit.</i> Evidenca 48: Udhëzues për përdorimin e Google Education Evidenca 73: Listë me leksione të hapura
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Nga RVB dhe takimi me drejtues, GVJ konstatoi se KUB operon në disa nivele të shqyrtimit dhe monitorimit të personelit të tij për të garantuar cilësi dhe profesionalizëm në çdo proces. Vlerësimi i aftësive të personelit kryhet: a) Nga eprori direkt (DSLIT), ku pedagogu i nënshtrohet vlerësimit në formën e kontrolleve të herë pas herëshme gjatë procesit mësimor si dhe vëzhgimit të punës mësimore në përshtatshmëri me syllabuset; b) nga studentët, kryesisht me anë të pyetësorëve, duke garantuar anonimitetin e tyre; c) zyra e NjBSC, që duke vlerësuar rëndësinë që ka mendimi i stafit, ka ndërmarrë zhvillimin e një pyetësori. Qëllimi i pyetësorit është të marrë informacion, qëndrimin dhe qasjen e stafit në lidhje me disa elementë të caktuar të procesit akademik. Evidenca 2: Statuti KUB, kreu IX Zhvillimi dhe ruajtja e standarteve të AL, nenet 81-82 Evidenca 58: Vendim SA nr. 12, 30.09.2024 krijimin e NjSBC Evidenca 6: Regullorja e NjSBC

	Evidenca 7: Raport vjetor i NjSBC - rezultatet e pyetësorëve të studentëve Evidenca 18 + 86: Pyetësorët nga NjSBC për studentët dhe pedagogët Evidenca 30: Raport vjetor i DSLT 2023-2024 Evidenca 5: Raporti IQE për vlerësimin e cilësisë TLE
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Sipas RVB e takimet e zhvilluara, GVJ konstatoi se NjBSC, si strukturë përgjegjëse, informon drejtuesit e Departamenteve, e përmes tyre të gjithë stafin e KUB, rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësisë të tij bazë dhe anëtarëve të personelit. Ev idenca 6: Regullorja e NjSBC Evidenca 7: Raport vjetor i NjSBC - rezultatet e pyetësorëve të studentëve
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ evidenton mbi bazën e DVV dhe vizitës në KUB se Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale ndihmon stafin akademik në rritjen e mëtejshme profesionale dhe synon inkurajimin e tyre për të ndjekur seminare apo forume të ndryshme që i aftësojnë ata në metoda të mësimdhënies si dhe formimit të tyre akademik. KUB nxit dhe zhvillon trajnime për stafin për përmirësimin e aftësive të tyre në procesin akademik. Për shkak se Kolegji ofron programe 2-vjeçare me karakter profesional, fokusi është në kërkimin e aplikuar. Puna kërkimore e personelit akademik përcaktohet nga Departamenti i Studimeve të Larta Teknike në kuadër të akteve rregullatore të KUB. KUB nxit organizimin e orëve të hapura si një formë e ndarjes së përvojës dhe praktikës në mësimdhënie, mbështet të gjitha punimet në fusha të praktikës, botimeve, artikujt shkencorë apo projekteve që stafi akademik ndjek gjatë kohës që është i angazhuar në procesin mësimor. Evidenca 9 + 35: Performanca shkencore e KUB 2019-2024 Evidenca 36: Book of Proceedings Evidenca 39: Leje promovimi stafi për Doktoraturë Evidenca 45: Monografi Prof. Shpëtim Cami Evidenca 64: Plani i veprimtarisë shkencore për stafin 2022-2023 Evidenca 57: Raporti vjetor KUB 2023-2024
Konkluzione GVJ konstaton se KUB ndjek një politikë që promovon cilësinë në mësimdhënie.	

- Vlerësimi i aftësive të personelit lidhje me mbarëvajtjen e procesit mësimor kryhet: a) nga eprori direkt, b) nga studentët, nga c) zyra e NjBSC.
- Instiucioni ka ndërmarrë zhvillimin e një ankete, me anë të një pyetësori, me qëllim për të marrë informacion, qëndrimin dhe qasjen e stafit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ nëpërmjet dokumentave, tabelave dhe takimeve, konstaton se personeli i KUB përbëhet nga personeli akademik, ndihmës mësimor (sekretaria) dhe personeli administrativ. Personeli i KSLP/KUB mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Kontrata e punës bazohet në legjislacionin në fuqi dhe përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve. GVJ konstaton se në programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, për vitin akademik 2024-2025 u angazhuan në mësimdhënie 12 pedagogë – 8 pedagogë me kohë të plotë dhe 4 me kohë të pjesshme. Nga pedagogët me kohë të plotë 1 është me titullin “Profesor i Asocuar”, 2 janë lektorë me gradën Doktor, dhe 5 janë asistent-lektorë me “Master i Shkencave”. Sipas Tabelave 6.1 e 6.2 paraqiten të dhënat për stafin që ka mbuluar programin e studimit në 2 vitet e fundit. <table><tr><td>Stafi akademik për</td><td>2023-2024</td><td>2024-2025</td></tr></table>	Stafi akademik për	2023-2024	2024-2025
Stafi akademik për	2023-2024	2024-2025		

	programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr. / Prof. Asoc.	-/-	1	-/1	-/-
	Dr. / PhD.	1 /-	-/-	2/	-/-
	MSc. / BSc.	3/-	5/-	5/-	4/-
	Totali	4	6	8	4
Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 6.1+6.2 cilësi e stafit mësimdhënës për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, për vitin akademik 2023-2024 dhe 2024-2025 Evidenca 60: Lista e stafit akademik të KSLP Evidenca 2: Statuti i KUB, Kreu V, neni 44 Evidenca 80: Kontratë pune tip për personel akademik me kohë të plotë https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/stafi-i-kolegjit-te-studimeve-te-larta-profesionale/					
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Ngarkesa mësimore për personelin akademik përcaktohet në Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL, pika II. 1, i ndryshuar me Udhëzim nr. 36, datë 23.11.2018 e Udhëzim nr. 37, datë 04.12.2018. Ngarkesa për Profesorë është 140 orë, për lektorë 165 orë. Ngarkesa për asistent-lektorë me Msc. është 195 orë, por mund të realizojë edhe 200 orë suplementare në auditor. Për autoritetet drejtuese Dekan/Drejtor është 70 orë, Përgjegjës departamenti është 90 orë. Nga sa më sipër, GVJ konstatoi se në programin e studimit në programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, për vitin akademik 2024-2025 personeli akademik efektiv (PAE), për vitin akademik 2024-2025 mbulonte 88 % të ngarkesës mësimore, ose nga 12 pedagogë që japin mësim vetëm 4 ishin me statusin part time që japnin gjithsej 13 % të orëve mësimore në këtë program (sipas tabelës 4). Ndërsa sipas tabelës 12.2 po për këtë profil “Energjetikë” të programit “Teknik i Lartë Elektrik”, për v.a. 2024-2025, personeli akademik efektiv mbulonte 71.67% dhe PAK 28.33%. <i>GVJ rekomandon ribërjen e saktë të tabelave 4 dhe 12.2 tek tabelat përmbledhëse 1-24.</i> Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 4 Ngarkesa totale e personelit					

C. Kyshtaj *God*

	akademik për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, profili “Energjetikë”, për vitin akademik 2024-2025; tabela 12.2 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik të programit TLE, profili “Energjistik” për v.a. 2024-2025 Evidenca 59: Ngarkesa mësimore lidhur me stafin akademik për v.a. 2024-2025
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstaton se në periudhën 2023-2025 ka treguar qëndrueshmëri të personelit akademik. Në 2 vitet e fundit personeli akademik është i njëjtë. Pra, Institucioni garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Përgjatë 2 viteve është konstatuar lëvizja e 2 personel akademik me kohë të pjesshme me titull Prof. As. që kanë kaluar si personel akademik me kohë të plotë. <i>GVJ konstaton se stafi akademik nënshkruan kontratë punësimi me institucionin dhe mbulohet me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</i> Evidenca 2: Statuti i KUB, Kreu V, neni 44 Evidenca 80: Kontratë pune tip për personel akademik me kohë të plotë
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga dokumentacioni i bashkëngjitur dhe nga takimi në Zyrën e BNj, administratës, arkivës e protokollit, GVJ konstaton se KUB ka përcaktuar politika të qarta të rekrutimit të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, referuar në Kodin e Punës² të RSH, Ligjin për arsimin e lartë³ nr. 80/2015 nenet 64, 65, 66, 67 dhe Statutin e KUB, neni 44. GVJ konstaton se stafi përzgjidhet me procedurë selektimi dhe intervistimi. Departamenti bën propozimin për staf të ri, aprovimin final e bën Rektori. GVJ konstatoi se rekrutimi i personelit akademik bëhet nëpërmjet procedurave të shpalljes publike të pozicionit të punës në rubrikën e njoftimeve në website-in zyrtar të KUB. Në njoftim, institucioni shpall pozicionin vakant, fushën e kërkuar me kërkesat e përgjithshme dhe ato specifike, që ka propozuar njësia bazë, të miratuara nga titullari i institucionit. Punësimi pranë KUB-it realizohet me procedurë të konkurrimit

² Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë neni 19, https://www.idp.al/wp-content/uploads/2017/03/Kodi_i_Pun%C3%ABs_2016.pdf

³ Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 80/2015, kreu 6, neni 57-68, https://www.unitir.edu.al/images/dokumenta/Legjislacion/Ligj_80-2015_22.07.2015.pdf

	të hapur publik, në një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv. Institucioni ka të sanksionuar në rregullore kriteret dhe procedurat për rekrutime të personelit akademik sipas dispozitave në Rregulloren e Marrëdhënieve të Punës⁴. GVJ ka konstatuar se rekrutimi dhe vlerësimi bëhet në mënyrë transparente. Për vlerësimin e kandidatëve ngrihet një komision <i>Ad-Hoc</i> i cili shikon të gjithë elementët që u shërbejnë kriterëve akademike të pozicionit të pedagogut dhe disiplinës shkencore që mbulon. Anëtarët e komisionit vlerësojnë me pikë çdo tregues të sjellë nga kandidati në përshtatshmëri me kërkesat e departamentit. Përzgjedhja dhe rekrutimi bëhet sipas nevojave në faza të ndryshme por gjithmonë në përputhje me procedurën, nxjerrjen e vendit të lirë, pritjen e aplikimit, përcaktimin e datës për testim, kontrollin e vlerësimin të detajuar të dokumentacionit të paraqitur, testimin, intervistën dhe vlerësimin transparent për secilin. Në fund bëhet klasifikimi dhe rankimi i tyre me pikë duke e bërë prezent për secilin kandidat. Pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes nënshkruhet Kontrata e Punës nga Rektori dhe del urdhëri i emërimit. Evidenca 2: Statuti i KUB, Kreu V, neni 44 Rekrutim staf: https://kub.edu.al/lajme/hapen-vendet-vakante-per-staf-akademik-full-time-ne-kolegjin-e-studimeve-te-larta-porofesionale-2-vjecare-ne-programet-teknik-i-larte-automobilash-teknik-i-larte-elektrik/
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ ka konstatuar se për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, janë në dispozicion laborator Elektrik dhe laboratorë të tjerë si i Elektronikës, i Mekanikës, i IT. Për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, Institucioni ka angazhuar 3 personel ndihmës akademik, të cilët luajnë rol të rëndësishëm në mbështetje të zhvillimit të aftësive praktike të studentëve. Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 6.1+6.2 cilësi e stafit mësimdhënës për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, për vitin akademik 2023-2024 dhe 2024-2025

⁴ Rregullore për marrëdhëniet e punës, neni 7-19 dok. Nr. 11, Dosja në arkiv

	Evidenca 71: Urdhër Rektor për emërim 3 laborantë Evidenca 60: Lista e stafit akademik të KSLP
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	GVJ konstatoi në evidencat në Departamentin e Studimeve të Larta Teknike, si dhe në vizitat në institucion se KUB mbledhin/ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”. Këto të dhëna përfshijnë të gjithë anëtarët e personelit akademik të programit të studimit, të personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Zyra e Burimeve Njerëzore, administratës, arkivës e protokollit është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit në lidhje me personelin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Përveç angazhimit në mësimdhënie në auditor, personeli akademik ka për detyrë të mbikqyrë studentët gjatë zhvillimit të praktikës mësimore. Në fund të çdo semestri paraqitet ngarkesa e realizuar për çdo anëtar stafi. Evidenca 80: Kontratë pune tip për personel akademik me kohë të plotë Evidenca 60: Lista e stafit akademik të KSLP Evidenca 16: VSA nr. 11, 30.09.2024 Strukturat mbështetëse Evidenca 59: Ngarkesa mësimore lidhur me stafin akademik për v.a. 2024-2025
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ evidenton se KUB ka garantuar që përveç laboratoreve të programit të studimit në dispozicion për procesin akademik, për pjesën e praktikës profesionale të vitit të dytë të sigurojë marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me kompani e biznese private. KUB/DSLIT, në marrëveshje dhe bashkëpunim me biznese e kompani, vë në dispozicion personelin e kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Personeli ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me personin mbikqyrës të studentit të caktuar nga subjekti pritës. Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese Evidenca 8: Lista e marrëveshjeve për praktika 23-24; 24-25 Evidenca 11 + 12: Rregullore për Praktikën mësimore + Udhëzues për përgatitjen e Praktikës profesionale Evidenca 17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KUB
Kriter 8. Personeli mbikqyrës	GVJ konstaton se subjekti pritës cakton një person mbikëqyrës

në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	për çdo student që kryen praktikën. Ky person është pikë kontakti me KUB dhe në përfundim të zhvillimit të praktikës plotëson një formular vlerësimi për studentin praktikant. Në fund të praktikës profesionale studenti përgatit një raport përfundimtar për punën e kryer dhe përvojë në subjektin pritës. Evidenca 11 + 12: Rregullore për Praktikën mësimore + Udhëzues për përgatitjen e Praktikës profesionale Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit TLE, neni 10
--	--

Konkluzione

- GVJ vlerëson që personeli akademik që mbulon programin e studimit 2-vjeçar profesional "Teknik i Lartë Elektrik" me 3 profile: "Energjetikë", "Elektromekanike" e "Automatizim Industrial", përmbush standardet për kualifikimin e duhur dhe të posaçëm akademik e profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.
- Rekrutimi i stafit akademik, ndihmës-akademik, personelit administrativ në KUB bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë.
- GVJ konstatoi se KUB mbledhin, ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit.
- KUB ka garantuar marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me kompani e biznese private.
- Personeli në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve dhe marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.
- GVJ rekomandon që Evidenca 59: Ngarkesa mësimore lidhur me stafin akademik për v.a. 2024-2025 të ribëhet për programin e studimit 2-vjeçar "Teknik i Lartë Elektrik" me 3 profile: "Energjetikë", "Elektromekanike" e "Automatizim Industrial" dhe të ribëhen saktë tabelat me nr. 4 dhe nr. 12.2 tek tabelat përmbledhëse 1-24.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron	GVJ konstaton se KUB dhe programi i studimit 2-vjeçar

Ce Xy shuej

40.2

mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	“Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme, për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike dhe praktike/laboratorike. Nga vizita në këtë institucion dhe dokumentacioni, rezulton se: KUB ka 1140 studentë, por rregullisht vijnë në mësim rreth 700-800 studentë. Konkreisht norma faktike në m² për një student në bazë të sipërfaqes që ka në dispozicion KUB, duke i shfrytëzuar kapacitetet me turne nga 598 studentë në turnin e parë dhe 542 studentë në turnin e dytë, rezulton 3.6 m²/student. Duke shtuar edhe ambientet e tjera të përbashkëta arrihet norma e përcaktuar në VKM me nr. 418, datë 10.5.2017⁵, që është 5 m²/student. Nga pikëpamja funksionale GVJ konstaton se hapësirat akademike plotësojnë kushtet në aspektin e lartësisë (çdo kat është 4 metra i lartë), ndriçimit dhe ajrosjes, izolim të sigurt nga zhurmat, shkallë emergjence, etj. Të gjitha objektet janë të pajisura me mjete mbrojtjes kundër zjarrit. Të gjitha fikset e zjarrit janë të vendosur në vende të dukshme dhe lehtësisht të arritshme në rast emergjence zjarri. Mësimi organizohet në grupe mësimore në përputhje me parashikimet ligjore për këtë natyrë programi studimi: grupe deri në 25 studentë në ushtrime, grupe me 10 -12 studentë në laboratore. Evidenca 69: Infrastruktura + laboratorët – Relacion mbi infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse të KUB Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 16 Mjediset e KUB Evidenca 82: Raport i MAS përcjellë me shkresë me nr. 6643/2, datë 02.12.2024 “Për kapacitetet pritëse”
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ vizitoi kabinetet dhe auditorët, ku zhvillojnë mësim studentët e programit të studimit dhe konstatoi se janë të pajisura me kompjutera të tipit laptop dhe me video-projektorë si dhe kanë akses në internet përmes sistemit WI-FI duke krijuar kështu të gjitha kushtet për realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik, si dhe duke iu dhënë mundësi personelit akademik e studentëve të shfrytëzojnë teknologjinë e informacionit për zhvillimin e mësimit me anën e metodave bashkëkohore. Evidenca 69: Infrastruktura + laboratorët – Relacion mbi infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse të KUB

⁵ VKM me nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucionëve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”; Aneksi 1 pika C. Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme e ndarë sipas fushave të studimit, për objektet që do të ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë, për Inxhinieri dhe teknologji është: **5 m² për studentë**”

	Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 16 Mjediset e KUB
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ vizitoi laboratorët e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” si dhe laboratorët e tjerë që përdoren nga studentët e këtij programi profesional 2-vjeçar, dhe konstatoi se për këtë program studimi janë në dispozicion 3 laboratorë: Laboratori Elektrik dhe Elektronikës, Laboratori i Mekanikës, Laboratori IT. Këto laboratorë janë ndërtuar në shërbim të këtij programi studimit dhe i kanë të gjithë pajisjet, aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit. Orë të veçanta mësimore realizohen nëpërmjet vizitave mësimore në institucione të ndryshme, me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi. Veçanërisht produktive kanë rezultuar në këtë drejtim Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor, Agjensia Kombëtare e Pyjeve, Kompanitë e Confindustrias, etj, mjediset e punës së tyre janë shndërruar në mjedise që studentët tanë i shfrytëzojnë në dobi të aftësimin praktik. Evidenca 69: Infrastruktura + laboratorët – Relacion mbi infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse të KUB Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 16 Mjediset e KUB Evidenca 17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KUB
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ nga vizita në institucion konstatoi se KUB, ofron për studentët dy laboratorë informatike, një me 24 kompjuterash (PC), dhe tjetri me 50 PC të cilët janë të lidhur në rrjet dhe në internet non stop. Laboratori i IT përveç aksesorëve të përmendur më sipër është i pajisur gjithashtu me softë/programe aplikative profesionale, si dhe një dërrasë elektronike dhe është i lidhur në rrjet. Në këto laboratorë punojnë studentët e të tre njësive dhe të të dyja cikleve të studimit, në shërbim të lëndëve/moduleve: si: “Bazat/Hyrje në Informatikë” dhe Menaxhim i Sistemeve të Informacionit” (MSI), “Informatikë Biznesi”, Teknologji Informacioni”, “Diagnostikimi i Automjeteve”, AutoCad, Programet e Inxh. Kompjuterike tek Godina A. Evidenca 69: Infrastruktura + laboratorët – Relacion mbi infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse të KUB
Konkluzione GVJ vlerëson që KUB ka vënë në dispozicion të programit të studimit “Teknik i Lartë	

(Signature)

Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës si dhe atë te formimit praktik.

- *Aktiviteti mësimor zhvillohet në kabinetet dhe auditorët, të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektorë, dhe foni, duke mundësuar përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies për studentët.*
- *Mjediset infrastrukturore plotësojnë normativat ligjore. Nga KUB deklarohet normativa 3.6 m²/student, por duke shtuar edhe ambientet e tjera të përbashkëta arrihet norma e përcaktuar në VKM me nr. 418, datë 10.5.2017⁶, që është 5 m²/student (sikurse del në evidencë edhe nga Raport i MAS përcjellë me shkresë me nr. 6643/2, datë 02.12.2024 “Për kapacitetet pritëse”).*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse (fizike dhe elektronike), e vënë në dispozicion të studentëve është në gjuhën shqipe dhe / ose në anglisht. Kjo literaturë është vendosur edhe në syllabuset përkatëse nga personeli akademik. Literatura e rekomanduar synon marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”. <i>GVJ evidentoi se për arsye të vështirësive të hartimit të teksteve shkollore për lëndët, një pjesë e konsiderueshme e lëndëve mbulohet nga literatura e përgatitur nga vetë stafi, në formën e cikleve të leksioneve, në përputhje me temat në syllabuset përkatëse. Këto materiale janë vënë në dispozicion të studentëve në bibliotekën e KUB.</i> Studentët përveç materialeve të printuara në kopje fizike, mund të shfrytëzojnë edhe platformat online si Google Education të

⁶ VKM me nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucionëve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”; Aneksi 1 pika C. Normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme e ndarë sipas fushave të studimit, për objektet që do të ofrohen nga institucionet e arsimit të lartë, për Inxhinieri dhe teknologji është: 5 m² për studentë”

	cilat i japin akses studentëve edhe në literaturë sipas lëndëve përkatëse që zhvillojnë. Evidenca: SYLLABUSET e programit TLE Evidenca 29: Fondi i titujve në bibliotekë
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	KUB ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, e vendosur në godinën e institucionit, e cila funksionon mbi bazën e një rregullore. Biblioteka zotëron një fond librash me rreth 1000 tituj, të cilët janë bashkëkohorë. Biblioteka mësimore e KUB garanton shërbim falas për studentët, personelin mësimdhënës e administrativ, si dhe për persona të tjerë të interesuar dhe mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”. Evidenca 43: Rregullore biblioteke Evidenca 29: Fondi i titujve në bibliotekë
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga dokumentat dhe vizita në institucion rezulton se Biblioteka e KUB është e pasur në numër të konsiderueshëm botimesh të viteve të fundit. Kontigjenti i librave ka ardhur nga blerjet të financuara nga KUB, donacioneve dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit me palë të treta, etj, si edhe nga projektet të ndryshme. Me fondin aktual kjo bibliotekë në përgjithësi garanton marrjen e njohurive të nevojshme nga ana e studentëve. Nga DVV dhe nga vizita në institucion, <i>GVJ konstaton se qëllimet, objektivat dhe parimet e bibliotekës janë në funksion të programeve të studimit, studentëve, personelit akademik.</i> KUB shpenzon fonde të planifikuara për blerjen e literaturës së specializuar për çdo program studimi ekzistues dhe programet e reja që hapen, si dhe në fushën e kërkimit shkencor që lidhet me programet e studimit apo me rolin dhe misionin e tij në fushën e edukimit. Për këtë qëllim, çdo vit por edhe në plan buxhetin e vitit akademik 2023 janë vënë në dispozicion nga rreth 300-350 mijë lekë për blerje librash. Evidenca 68: Relacion miratim Buxheti v 2024, fondi për blerjen e librave për bibliotekën fq. 5 Evidenca 29: Fondi i titujve në bibliotekë
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online	Në KUB është siguruar aksesimi i studentëve në disa biblioteka elektronike të huaja për të cilat institucioni ka bërë abonim një vjeçar ose stafi dhe studentët mund të kenë akses falas: Këto biblioteka online janë:

të fushës së programit të studimit.	1. https://www.questia.com/ ku kanë akses studentët e FE dhe FD me abonim një vjeçar. 2. https://www.ithaka.org/ 3. https://www.academia.edu/ që mund të aksesohet pa pagesë. GVJ konstatoi gjithashtu se studentët mund të kenë akses në disa biblioteka apo platforma elektronike falas, të cilat janë si vijon: http://www.gutenberg.org/ www.ebsco.com; https://al.cobiss.net/ (më lehtë e aksesueshme nga ana e studentëve dhe e stafit e cila përmban libra në gjuhë të huaj dhe në gjuhën shqipe). https://www.thefreelibrary.com/ http://www.ebrary.com/corp/ https://www.dlib.si/?&language=eng Evidenca 29: Fondi i titujve në bibliotekë
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	Nga vizita në Bibliotekë, GVJ konstatoi që ajo ofron të gjitha kushtet logjistike dhe ergonomike, është e pajisur me kompjutera, softuere dhe me pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin për të gjithë studentët. Biblioteka nëpërmjet teknologjisë është e pajisur me një sistem dokumentacioni dhe informacioni për një shërbim efektiv ndaj studentëve dhe pedagogëve. Sistemi i krijuar mundëson shkëmbimin e të dhënave me Bibliotekën Kombëtare, bibliotekat europiane si dhe vendosjen e partneritetit me institucione brenda dhe jashtë vendit për shkëmbim e huazim të informacionit (abonime online). KUB ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line. Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 17 Të dhëna për platformat on-line / Strukturat teknologjike
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka ka personelin përkatës që angazhohet për të shërbyer në kohën e programuar për studentët. Biblioteka është e hapur prej orës 9.00-20.00 në përputhje me oraret e zhvillimit të mësimin në KUB. Orari i shfrytëzimit është në varësi të kohës së preferuar të studentëve dhe është i përcaktuar në bashkëpunim me qeverisjen studentore. Në këtë mënyrë studentëve që kanë mësim para dite u krijohet mundësia të tërheqin literaturën e nevojshme apo të ulen të studiojnë dhe punojnë pas përfundimit të mësimin. Studentët që e zhvillojnë mësimin mbasdite kanë mundësinë që në orare para fillimit të mësimin të marrin në bibliotekë literaturën e nevojshme ose të ulen në sallën e saj për studim.

	Evidencë 43: Rregullore biblioteke Evidenca 50: Model kërkesë për tërheqje libra në bibliotekë			
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitet përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	Sipas RVB dhe nga takimet me drejtuesit GVJ konstatohet se KUB bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve. Biblioteka krahas punës së përditshme për administrimin e fondit dhe lehtësimin e punës së stafit dhe studentëve, si rregull raporton tek autoritetet drejtuese të KUB mbi sasinë e fondit fizik dhe gjendjen e tij. Gjithashtu ajo ndjek afatet e vlefshmërisë së kontratave për ato biblioteka online për të cilat KUB paguan tarifën përkatëse. Në këto raportime zënë vend edhe kërkesat për pasurimin e fondit apo për instalimin e programeve kompjuterike më të avancuara të cilat identifikohen dhe realizohen nga çdo departament me buxhetin e KUB. Përgjegjësit e programit të studimit hartojnë plane për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programeve. Në mënyrë sistematike kërkohet nga pedagogët që leksionet, librat apo botime të depozitohen në bibliotekë.			
Konkluzione - GVJ konstaton se programi i studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” përmban literaturën e nevojshme të detyruar dhe të rekomanduar. Ajo është në mbështetje të mësimdhënies. - KUB ka ndërtuar edhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, si bibliotekën, mjedise të posaçme, shlodhëse dhe rekreative. - GVJ konstaton që KUB ndjek një procedure të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës. Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit dhe funksionon mbi bazën e një rregullore të miratuar. - KUB ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”. Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit

akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	Nga vizita në sekretari, GVJ u informua që KUB ka krijuar sistemin kompjuterik të menaxhimit, nëpërmjet të cilit administron të dhënat / database për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga sekretaria mësimore, ku përdorimi i databazës kompjuterike është komplementuar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi. Çdo studenti në KUB i hapet një dosje me dokumentat që paraqet në sekretari ku përfshihet kërkesa, dokumenti i identifikimit, dëftesa e pjekurisë, kontrata që lidhet midis dy palëve, fotot e tij, numrat e kontaktit dhe adresa e e-mailit. Institucioni disponon një domain-name dhe një domain e-maili, i cili është implementuar në server-at e Microsoft në mënyrë që të bëhet i aksesueshem nëpërmjet Office 365, apo Outlook Express. Të gjitha pajisjet kompjuterike janë të vendosura në rrjet, i cili kontrollohet nga një server mail-server. Ky sistem e ndihmon institucionin që të menaxhojë gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga fillimi i studimeve deri në përfundim të tyre dhe më pas. Në vitin 2023-2024 për sekretarinë u implementua sistemi "Edu 4school" për P-V e notave të studentëve, ku kanë akses Drejtori i KSLT, Kryesekretarja dhe pedagogët. <i>GVJ i rekomandon Institucionit vënien në përdorim të një platforme (sistemi on-line) për përdorim nga sekretaria, stafi, studentët me akses të dedikuar, sipas detyrave të tyre (regjistrimin e të dhënave të studentëve nga sekretaria; hedhje notash, materialesh mësimore nga stafi; lexim notash nga studentët, etj).</i> Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 17 Të dhëna për platformat on-line / Strukturat teknologjike Evidenca 2: Statuti KUB, Kreu VII, neni 76 Baza e të dhënave të studentëve, neni 77 Sekretaria mësimore, neni 78 Dokumentacioni i procesit mësimor Evidenca 78: Rregullore e sekretarisë mësimore Evidenca 79: Rregullore arkivi
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm	GVJ nga takimi me personelin e KUB konstatoi se Zyra e

i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	burimeve njerëzore, administratës, arkivës e protokollit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Punonjësi i burimeve njerëzore, menaxhon dokumentacionin personal të punonjësve si dhe plotëson rregjistrin themeltar. Ndjek procedurat për kontratat e punës për të gjithë punonjësit e KUB. Hedh të dhënat e çdo punonjësi në rregjistrin themeltar. Nxjerr të dhëna nga dosjet e personelit kur kërkohen, bazuar në ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale. Departamenti, mban, ruan dhe administron, në përputhje me rregullat zyrtare, të gjithë dokumentacionin e departamentit si njësi administrative, ashtu edhe ato të stafit akademik që lidhen me procesin mësimor dhe administrativ, sipas akteve ligjore dhe nënligjore. Përgjegjësi i departamentit plotëson dhe nënshkruan realizimin e ngarkesës mësimore, semestrale dhe vjetore të anëtarëve të departamentit, miraton tezat e provimeve, organizon aktivitete të ndryshme shkencore ose veprimtari të tjera që lidhen me funksionimin administrativ të departamentit dhe të procesit mësimor si dhe angazhohet për të lidhur marrëveshje me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Departamenti i Studimeve të Larta Teknike, nëpërmjet Drejtorit të KSLP ose përgjegjësit të departamentit, informohen për të gjitha procedurat dhe rregulloret e brendshme në lidhje me programin e studimit dhe procesin mësimor. Përdorimi i platformës Microsoft Office 365 apo Outlook Express, i grupeve të përbashkëta në aplikacione të ndryshme bën të mundur informimin e shpejtë të studentëve për dinamikën e ndryshimeve ditore apo javore. Pjestarët e stafit dhe studentët kanë mundësinë të përditësojnë dokumentacionin e tyre. Në website-in e KUB, në rubrikën “Portali” e në të gjitha rubrikat e tjera të tij ka informacion dhe dokumenta mbi aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ, si: mbi strukturën e njësive kryesore dhe njësive bazë, emrat e stafit të angazhuar në mësimdhënie, të dhëna të përmbledhura për secilin prej tyre, lëndët/modulet që ata japin, leksionet e lëndës/modulit. Website: https://kub.edu.al/
---	---

	Protali: https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/ Evidenca 63: Udhëzues për përdorim Portali elektronik KUB
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nëpërmjet adresave të emailit që disponon secili pjesëtar i stafit dhe studentët kanë akses të dedikuar në informacione dhe dokumente të shkarkuara në sistemin e brendshëm të menaxhimit PORTALI i KUB. Secilit pedagog i garantohet akses nëpërmjet një adrese emaili të ndërtuar me shkronjën e vogël të emrit dhe mbiemrin @ kub.edu.al. Ndërsa studentëve u është hapur adresë emaili me: emri mbiemri @ kub.edu.al. Për përdorimin e këtij sistemi menaxhimi (të Portalit) ka dhe një guidë të hartuar për këtë qëllim për stafin dhe për studentët. Sekretaria mësimore e KUB mundëson shërbime për këta grupe përdoruesish: Rektor, Dekan/Drejtor, Përgjegjës Departamenti, Sekretare, Studentë, Pedagog, Zyra e Koordinimit, Zyra e Studentit dhe këshillimit të karrierës, Zyra e programimit dhe raportimit financiar, Zyra e marrëdhënieve me publikun, etj., përmes një sistemi kompjuterik (databaze elektronike) që ndihmon procesin mësimor në të gjithë komponentët. Evidenca 21: Guida e studentit Evidenca 48: Udhëzues për përdorimin e Google Education Evidenca 63: Udhëzues për përdorim Portali elektronik KUB
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	GVJ bazuar në DVV, konstaton se KUB ka në përdorim platforma dhe module të veçanta që mundësojnë komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. Sistemi i brendshëm i menaxhimit platforma “Portali”, mundëson nëpërmjet e-mailit forma komunikimi interaktiv midis studentëve dhe stafit akademik, pedagogët me njëri-tjetrin dhe me nivelet drejtuese. Platforma Microsoft Teams dhe Google Classroom ndihmojnë për aksesimin e moduleve, mësim online dhe komunikim të brendshëm elektronik. Kjo u krijon mundësinë studentëve që të marrin leksionet e shkurtuara të hedhura nga ana e pedagogëve, të komunikojnë për sqarime të ndryshme, të dorëzojnë detyrat e kursit, etj. Portali: https://sites.google.com/a/uab.edu.al/portal/ Leksionet: https://sites.google.com/a/uab.edu.al/olition-rumbullaku/leksione
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të	Nga takimet në Institucion konstatojmë se sistemi i brendshëm i menaxhimit që KUB ka krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ sepse të

aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	lejon të shkëmbesh informacion dhe të dhëna nëpërmjet aksesit të dedikuar apo nëpërmjet materialeve të hedhura në rubrikat e faqes së web-it të KUB. Në këtë mënyrë secili anëtar i personelit akademik dhe administrativ mund të raportojë në kohë reale në rektorat, dekanate/drejtori dhe departamente. Sistemi kompjuterik i sekretarisë mësimore në KUB, garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Në faqen e web-it të KUB gjendet informacion mbi Kolegjin e Studimeve të Larta Profesionale dhe programet e studimit që ofron kjo njësi kryesore, jepen të dhëna për urdhërin e MASR për ngritjen e kësaj njësie, departamentet përbërëse të saj, profilet e secilit program studimi, kurrikula e secilit prej tyre, objektivi i programeve të ofruara nga KSLP dhe të dhëna për stafin akademik. Këtu gjendet edhe informacioni mbi programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”. https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/			
Konkluzione				
<i>GVJ konstaton se KUB disponon një sistem të brendshëm institucional “Portali” që menaxhon, administron dhe bën monitorimin e aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Ky portal siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. sipas detyrave të tyre (ngarkim materialesh mësimore, leksione, etj).</i> <i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga sekretaria mësimore, ku përdorimi i platformës së informatizuar është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe akteve nën ligjore në fuqi.</i> <i>Programi i integruar “Edu4school” i RASH, i blerë nga KUB gjatë vitit 2024, siguron unifikim sipas standardeve më të mira të automatizimit të procesit, nga regjistrimi deri në diplomim të studentit.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe

mbështetjese studentëve	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ konstaton se KUB zbaton kërkesat ligjore duke raportuar çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij, që përfshin edhe tarifat e shkollimit, administrimin e të ardhura financiare/bursave/fondeve kërkimore, etj. Zyra e programimit dhe raportimit financiar (ZPRF) të KUB nën drejtimin e Administratorit përgatit çdo vit Pasqyrat financiare, për të ardhurat, shpenzimet, numrin e studentëve, si dhe informacione të posaçme për çdo njësi kryesore, në nivel njësi bazë (departamenti) dhe programe studimi. Në këtë kuadër GVJ konstaton se, financimi i programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” varet nga buxheti i KUB, i cili miratohet çdo vit në Senatën Akademik (SA) dhe Bordin e Administrimit (BA), duke garantuar siguri për qëndrueshmërinë financiare në mbulimin e të gjitha veprimtarive të qëndrueshme dhe operative për zhvillimin e tij. Nëpërmjet planifikimit të buxhetit për çdo vit pasardhës, i cili realizohet në mënyrë periodike, si rregull në përfundim të vitit, ZPRF përgjegjëse për financat e KUB, ndër të tjera harton edhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për vitin pasardhës si dhe harton buxhetin afat mesëm, i cili mbulon një periudhë dy/tre vjeçare, çka jep mundësinë për një plan mbështetjeje financiare për të paktën një cikël të plotë studimi. Evidenca 67 + 68: Relacion mbi realizimin e treguesve financiarë për vitin 2023 e plani për v. 2024 Evidenca 57: Raporti vjetor KUB 2023-2024
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet	Sipas RVB, në KUB hartohet plan-buxheti si IAL në nivele të detajuara si njësi kryesore dhe njësi bazë për programet e studimit. Në planet vjetore të buxhetit përfshihen edhe financimi i burimeve njerëzore që përdoren për realizimin e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, si një nga 3 programet e studimit që ofron Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTI), i njësisë bazë Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP). GVJ, mbi bazën e “Relacionit mbi realizimin e treguesve financiarë” evidenton se janë parashikuar fonde për shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzime për laboratorët e

financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	KSLT, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës (si dhe softet e integruara për administrimin e marrëdhënieve të studentëve me sekretaritë dhe për raportimin financiar), për aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, për projekte apo zëra të tjerë. Fondi për kërkimin shkencor si një zë shumë i rëndësishëm për IAL-në është parashikuar 5.48% e totalit të shpenzimeve vjetore. Evidenca 67 + 68: Relacion mbi realizimin e treguesve financiarë për vitin 2023 e plani për v. 2024 Evidenca 57: Raporti vjetor KUB 2023-2024
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Siç deklarohet: <i>Mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare kryhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe duke respektuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Funksionet administrative, ekonomike dhe financiare realizohen nëpërmjet Zyrës së programimit dhe raportimit financiar të KUB, i cili është një urë komunikimi dhe me Bordin e Administrimit.</i> Në bazë të DVV, GVJ konstaton se me kërkesë të BA të KUB bëhet auditim me kompani ndërkombëtare auditimi, si Grant Thornton, me të cilën prej 7 vitesh vlerësohet dhe dokumentohet gjendja e financimit dhe efektiviteti financiar i tij. Raportet e auditit dhe Pasqyrat Financiare të KUB, diskutohen në mbledhjen e zgjeruar të BA ku përcaktohen detyra për përmirësimin e treguesve financiar të KUB dhe depozitohen e publikohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Planifikimi financiar i KUB përmban tabelat për të ardhurat që parashikohet të krijohen si dhe planifikimin e ndarjes së burimeve financiare, të cilat janë të detajuara për çdo vit dhe të miratuara nga organet kolegjiale SA dhe BA. KUB ka hartuar planin financiar afatmesëm për periudhën 2024-2026. Evidenca 4: Raporti Grand Thornton Audit i jashtëm për vitin 2023 Evidenca 81: Vendim nr. 4, datë 30.03.2024 “Për miratimin e pasqyrave financiare për vitin 2023 dhe afatmesëm të KUB Evidenca 67 + 68: Relacion mbi realizimin e treguesve financiarë për vitin 2023 e plani për v. 2024
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për	Në analizën për realizimin e buxhetit në SA Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar (ZPRF) raporton për realizimin e treguesve të buxhetit në tërësi për institucionin. Gjatë

programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	diskutimeve evidentohen edhe problematikat që dalin për mbështetjen financiare të programeve të veçanta të studimeve. Evidenca 4: Raporti Grand Thornton Audit i jashtëm për vitin 2023 Evidenca 67 + 68: Relacion mbi realizimin e treguesve financiarë për vitin 2023 e plani për v. 2024 Evidenca 57: Raporti vjetor KUB 2023-2024, pjesa e dytë, Kreu VII Të dhëna për planin buxhetor dhe planin strategjik të KUB
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	KUB deklaron se ka garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon se ka mundur për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. KUB shqyrton dhe analizon kostot duke kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. Me qëllim mirë-menaxhimit të këtyre fondeve dhe sigurimit të një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vetë institucionit. KUB llogarit koston për të gjithë institucionin sipas metodologjisë standard, që ka për bazë llogaritjen e shpenzimeve në total/ shpenzime të departamentit me numrin total të studenteve / numri i studenteve për departament. Në bazë të DVV, GVJ evidenton se KUB, përveç sa më sipër, gjeneron të ardhura edhe nga shërbime për të tretë apo trajnime të ndryshme, (për strukturën e ndryshme të fakulteteve/kolegjit dhe ofrimin e programeve të studimit të profileve të shumta të ndryshme), duke diversifikuar burimet e fitimit. Evidenca 67 + 68: Relacion mbi realizimin e treguesve financiarë për vitin 2023 e plani për v. 2024 Evidenca 57: Raporti vjetor KUB 2023-2024, pjesa e dytë, Kreu VII Të dhëna për planin buxhetor dhe planin strategjik të KUB
Konkluzione • GVJ vlerëson se KUB garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” dhe mbështetjen e studentëve. • KUB zhvillon aktivitetin si institucion privat i arsimit të lartë dhe çdo vit harton një raport financiar të gjendjes financiare të shoqërisë dhe fluksit të parasë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. • KUB ka kryer auditimin periodik çdo vit nga palë të treta, duke vlerësuar dhe dokumentuar	

gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, si edhe raporton çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhura financiare / bursave / fondeve kërkimore, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KUB / Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP) / Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTL), si njësi bazë që ofron programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, kanë hartuar kuadrin ligjor si rregullore, udhëzime, procedura, të cilat zbatohen në të gjithë rrugëtimin e një studenti: informimin, pranimin, përparimin, transferimin/njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimin e dijeve/ankimimin dhe në fund diplomimin e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Statutin e institucionit. KUB kujdeset edhe për studentët pas diplomimit. KUB ka të përcaktuar strategjinë e zhvillimit të tij në planin strategjik 2024-2030; ka të normuar aktivitetin akademik në Statutin e tij; ka të përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë me rregulloret përkatëse. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e KUB zhvillohet në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet përkatëse. I gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e brendshme të institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, i transmetohet

(Signature)

	studentëve në: - Me guida, manuale, rregullore të cilat i vihen në dispozicion studentëve; informacione të shpallura: si orari, njoftime, etj; - Informacione në format elektronik, ku burimi kryesor mbetet faqja website e KUB dhe komunikimi me email përmes portalit; - Takime të drejtpërdrejta të studentëve, apo grupit mësimor. Evidenca 2: Statuti i KUB Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB Evidenca 37: Rregullore e kolegjit KSLP Evidenca 38: Rregullore e departamentit DSLT Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit në TLE Evidenca 89: Plani masave KUB 2024-2025, VSA nr. 8, 30.09.2024, Shkresë Rektor nr. 911, 30.09.2024 info për MAS
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe procedurat në hyrje në KUB, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë, sepse bëhen <i>nëpërmjet</i> Maturës shtetërore dhe U-albania që është ngritur mbi politikën <i>meritë-preferencë</i> të kandidatëve për studentë. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, të ndjekura nga KUB, janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Ato kanë garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë duke përfshirë dhe studentët e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”. KUB për këtë program studimi, si program profesional 2-vjeçar, nuk ka kusht të notës mesatare për kandidatët. Evidenca 2: Statuti i KUB, Kreu VI “Organizimi i studimeve”, nenet 55, 56/1, 61, fq. 29-31 Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Kreu IX “Organizimi i studimeve”, nenet 60, 62, 65, fq. 41-43 Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit në TLE, neni 5
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e	Sipas RVB e DVV, kriteret e pranimit të studentëve për çdo program studimi për Kolegjin Universitar të Biznesit për çdo vit akademik përcaktohen me Vendim Senati Akademik. Sipas akteve ligjore në fuqi⁷, KUB ka detyrimin e dorëzimit të kriterëve të pranimit të studentëve dhe të kuotave përkatëse çdo

⁷ Udhëzim i MAS, nr. 12, datë 30.06.2023, “ Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë ”, pika 8/b.c.d.e. (Në RVB – Evidenca nr. 70)




studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	vit akademik pranë Ministrisë përgjegjëse për arsimin, për çdo program në përputhje me kapacitetet që disponon institucioni dhe që i nënshtrohen verifikimit nga kjo ministri. Pas miratimit këto vendosen në portalin U-Albania. GVJ konstaton se KUB përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit që ofron, nëpërmjet shpalljeve në ambientet e tij dhe të publikimit në faqen e internetit të KUB, si edhe informimit nëpërmjet website, rrjeteve sociale, etj. Informimi dhe ndërgjegjësimi për t'u regjistruar në KUB realizohet në përputhje me "Politikën e procedurat e Komunikimit në KUB", nëpërmjet këtyre formave: takimeve informuese me nxënësit e shkollave të mesme, shpërndarje e fletëpalosjeve, postera, broshura, etj, dalje publike të përfaqësuesve të KUB në media dhe /ose në panairë e evente të ndryshme, etj. Evidenca 83: Vendim i SA nr. 4, datë 01.03.2025 për miratimin e kuotave të v.a. 2025-2026 (Shkresë e KUB për MAS për kuotat) Evidenca 21: Guida e studentit Lajme në Web: http://kub.edu.al/category/lajme/ Studio në Web: https://kub.edu.al/studio-ne-kub/
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstaton se në të gjitha strategjitë, rregulloret ku përfshihen kriteret/procedurat e pranimit, përparimit përgjatë kursit të studimit, transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, janë shkruar në gjuhë të kuptueshme për studentin dhe janë të publikuara në faqen elektronike të KUB. Ato janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga kandidatët për studentë dhe publiku. Faqja zyrtare përmban informacion të detajuar në lidhje me: strukturën dhe organizimin e KUB, programet mësimore, shërbimet, pranimet dhe kriteret e pranimit, aktet rregullatore të Institucionit, mundësi aplikimi për punë dhe kontakte, informacione të cilat përditësohen me kujdes në përputhje me Politikën e Menaxhimit të faqes së Internetit. Në fillim të çdo viti akademik KUB dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) listën e studentëve të regjistruar. Procedura e pranimit bëhet sipas udhëzimit të MAS. Transferimi i studimeve, njohja dhe njehsimi i diplomave është përcaktuar qartë në Statutin e KUB dhe në rregulloren e programit të studimit "Teknik i Lartë Elektrik" me 3 profile:

	“Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”. Për studentët që vijnë me transferim, <i>Komisioni i Ekuivalentimit të Studimeve (KES)</i> vlerëson lëndët dhe modulet që i njihen dhe vendos se cilat lëndë apo module duhet të jap provim për t’u përputhur me kurrikulën e programit të studimit sipas kërkesave të rregullores së ekuivalentimit të studimeve në KUB. Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Kreu IX “Organizimi i studimeve”, neni 67, fq. 43 dhe nenet 75-78, fq. 45-46 Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit në TLE, neni 6, fq. 5, neni 23 fq. 15 Evidenca 20 + 31: Rregullore për ekuivalentimin e studimeve
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Sipas RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni përpara fillimit të çdo viti akademik harton, miraton dhe publikon kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe të shtresave të marginalizuara. Këto kritere përcaktohen në kërkesat për kuota studentësh që i bëhen MAS para fillimit të çdo viti akademik. Në këto kuota janë të evidentuara dhe numrat e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave apo të shtresave të marginalizuara.
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ evidenton se një nga prioritetet e KUB është të vlerësojë punën dhe meritat e çdo studenti dhe në të njëjtën kohë ta motivojmë atë. KUB ofron bursa në varësi të mesatares së notave në maturën shtetërore dhe/ose në vitet e studimit në KUB. Gjithashtu KUB ndan informacione të ndryshme në lidhje me mundësitë për bursa apo financime për studentët. Evidenca 21: Guida studentore, fq. 28. Evidenca 83: Vendim i SA nr. 4, datë 01.03.2025 për miratimin e kuotave të v.a. 2025-2026 (Shkresë e KUB për MAS për kuotat)
Konkluzione - GVJ vlerëson se KUB ka hartuar, ndjek dhe zbaton politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”. - GVJ vlerëson si shumë të dobishme “Politikën e procedurat e Komunikimit në KUB”, që sjell	

Ceryshes

God

informimin e të interesuarve dhe transparencë.

- KUB si institucion privat i arsimit të lartë i nënshtrohet të gjithë kornizës ligjore në fuqi në lidhje me pranimet për studentët me aftësi të veçanta ose për disa kategori të veçanta.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga informacioni në DVV dhe nga takimet me studentë, GVJ konstaton se studentët, janë njohur dhe të qartë, lidhur me kriteret në përparimin akademik, kalimin nga një vit në tjetrin dhe kriteret për kalimin në çdo lëndë. Pranë KUB funksionon Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), e cila në kuadër të politikave të pranimit jep informacion për KUB dhe programet e studimit që ofron si dhe orienton të interesuarit te zyrat përkatëse, Sekretaria Mësimore, Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkiv-protokollit, dhe Zyra e Koordinimit, të cilët luajnë një rol thelbësor në informimin dhe koordinimin e punës me studentët dhe stafin akademik. Në faqen e internetit publikohet dhe përditësohet informacion i plotë, i saktë dhe i detajuar në lidhje me ofertën akademike të KUB, me organizimin e vitit akademik, sezonet e provimeve, etj. Për të kaluar nga njëri vit në tjetrin studenti duhet të ketë fituar 31 kredite ECTS. Evidenca 21: Guida e studentit, fq. 25-26 Evidenca 14: Rregullore për Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Kreu VI "Organizimi dhe funksionimi i njësive ndihmëse dhe administrative", neni 33 Zyra e Koordinimit, neni 35 ZSKK; Kreu XII "Kontrolli i dijeve", neni 101 "Kriteret e kalimit në vitin pasardhës" Evidenca 10: Rregullore e programin TLE, neni 4 Organizimi i studimeve Evidenca 13: Rregullore për zhvillimin e provimeve SYLLABUSET e programit TLE

C. Kyshtes

Q. Sh.

	Orari mësimor https://kub.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Orari-Kslp-21-Prot-Janar-2025.pdf https://kub.edu.al/wp-content/uploads/2025/01/Nr-31-Prot-dt-22.01.2025-Grafiku-i-provimeve-FEDShS-Dimer-2024-2025.pdf
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloret e KUB dhe të programit të studimit ka edhe kritere / procedura për njohjen e kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. Në fillim të vitit akademik, gjatë javës së orientimit, sidomos studentët e vitit të parë, departamenti i informon në mënyrë të hollësishme në lidhje me kriteret dhe procedurat e kalimit nga një vit në tjetrin. Ky informim bëhet nga ana e Departamentit të Studimeve të Larta Teknike (DSLTT) dhe nga secili pedagog në fillim të secilit semestër. Për studentët që rregjistrohen si program i dytë ose transferohen në programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, Komisioni i Ekuivalentimit të Studimeve (KES) bën njohjen e krediteve të fituara dhe ekuivalentimin e lëndëve. Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Kreu IX “Organizimi i studimeve”, neni 67, fq. 43 dhe nenet 75-78, fq. 45-46 Evidenca 10: Rregullore e programit të studimit në TLE, neni 6, fq. 5, neni 23 fq. 15 Evidenca 20 + 31: Rregullore për ekuivalentimin e studimeve, nenet 10-14 https://kub.edu.al/pranimet/#tarifat-dhe-transferimet
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton se në fillim të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe njohurive të parashikuara në aktet rregullatore të KUB, si në Rregulloren e KUB, Rregulloren e programit të studimit TLE. Këtu përfshihen procedurat që duhen ndjekur, rregullat e hartimit të tezave, monitorimi i provimeve, e drejta e studentit për të hyrë në provim ose jo, vlerësimi i studentëve. Edhe në syllabus-in e çdo lënde, të cilat vihen në dispozicion të studentëve përcaktohen kriteret dhe procedurat e vlerësimit të njohurive. Vlerësimi, i shprehur në notë në rregulloret ka të përcaktuar qartë mënyrën, modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijes dhe veçanërisht të provimeve e riprovimeve që stafi akademik dhe studentët duhet të ndjekin. Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Kreu IX “Organizimi i

C. K. Shkëlq

God

	studimeve”, nenet 70-74, Kreu XII “Kontrolli i dijeve”, nenet 94-100 Evidenca 10: Rregullore e programin TLE, neni 13 Kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlerësimit Evidenca 13: Rregullore për zhvillimin e provimeve SYLLABUSET e programit TLE
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se KSLP/DSLIT ndjekin një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit. Në rregullore janë parashikuar kriteret dhe procedurat e diplomimit. <i>GVJ evidenton se brezi i parë i studentëve të programit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” do të diplomohet në vitin aktual 2024-2025.</i> Studentët vihen në dijeni për procedurat e lidhura me provimet dhe diplomimet nëpërmjet tutoriatit, komunikimeve para provimeve me anë të postës elektronike e-maileve, sekretarisë mësimore, titullarit të lëndës dhe publikimit në mjediset e KUB. GVJ konstaton se studentet informohen rregullisht se në përputhje me Statutin dhe Rregulloren KUB, Rregulloren e Programit të Studimit dhe në fund të vitit të dytë akademik, pasi kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe financiare, i nënshtrohen provimit përfundimtar (diplomimit) i cili jepet me gojë para një komisioni të ngritur nga Drejtoria e KSLP me propozim të DSLT. Studentëve u jepen udhëzime paraprake për të gjithë procedurën dhe pyetjet orientuese për detyrimet përmbyllëse. Evidenca 10: Rregullore e programin TLE, neni 18 Provimi përfundimtar i diplomimit Evidenca 13: Rregullore për zhvillimin e provimeve Evidenca 75: Set i pyetjeve përfundimtare Evidenca 40: Urdhër Rektor për diplomimin Evidenca Udhëzim i Drejtorisë së KSLP “Për Procedurat e të Zhvillimit të Provimit të Diplomimit në Programet e Studimeve të Larta Profesionale në KSLP
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e	GVJ konstaton se përpara fillimit të çdo viti akademik por edhe në mënyrë periodike, KUB publikon fletëpalosje me informacion të përmbledhur për gjithë institucionin dhe programet e studimit që ofrohen prej tij. Në sitin e KUB kandidatët për studentë gjejnë Guidën e Studentit me informacion mbi institucionin.

studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Një formë tjetër, janë takimet që zhvillohen me maturantët në ZA e rretheve për këshillimin e karrierës. Po ashtu, KUB merr pjesë rregullisht në panairët “Work and study” apo në panairin e profesioneve. Përveç kësaj KUB fton për vizitë në mjediset e tij drejtues të shkollave të mesme, mësues dhe maturantë nga shkolla të ndryshme të vendit. Në faqen e web-it të KUB është një rubrikë e veçantë e titulluar “Pranimet” ku është publikuar një informacion i hollësishëm për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm. Në interes të informimit të të interesuarve KUB dhe stafi i tij përdorin spotet dhe programet televizive, shtypin periodik dhe panairët e ndryshme të edukimit. Evidenca 21: Guida studentore Evidenca 72: Njoftime, rrjete sociale, web https://kub.edu.al/panairi-work-and-study/ https://kub.edu.al/events/panairi-i-pare-i-profesioneve/ https://kub.edu.al/events/vazhdojne-vizitat-e-maturanteve-ne-mjediset-e-kub/ https://kub.edu.al/pranimet/ https://www.facebook.com/www.kub.edu.al/videos/413750040865846
---	---

Konkluzione

- GVJ vlerëson se KUB vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimeve “Teknik i Lartë Elektrik”, me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.
- Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, KUB publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.
- Faqja zyrtare Web është burim i rëndësishëm informacioni të nevojshëm në lidhje me programin mësimor. Institucioni informon studentët dhe publikun edhe përmes broshurave, fletëpalosjeve dhe fushatave të informimit.
- Informim tek studentët jep edhe Sekretaria Mësimore, në drejtim të rregullave për frekuentimin, kalimin në vitet pasardhëse, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të

(Signature) *(Signature)*

hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Nga takimi me studentët GVJ konstatohet se ato informohen në fillim të vitit për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”. Informacioni në lidhje me programin e studimit, stafin akademik që e mbështet, detyrimet e të dy palëve, etj, është detyrë e Koordinatorit të DSLT, pedagogëve të çdo lënde, Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkiv-protokollit, Zyra e Koordinimit, si edhe Sekretarisë Mësimore. Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Kreu IX “Organizimi i studimeve”, nenet 70, 72 Evidenca 10: Rregullore e programin TLE, neni 4 Organizimi i studimeve Evidenca 27: Struktura akademike, plani mësimor, orari
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/ modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studenti njihet me informacionin kryesor i cili gjendet në hard copy në Rektorat, Drejtorinë e KSLP dhe DSTLE. Këtë informacion studentët e gjejnë në çdo kohë duke përdorur faqen e web-it të KUB, ku në rubrikën “Fakultetet” tek Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale, gjendet informacion mbi 3 profilet “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik”, kreditet që studenti fiton në përfundim të këtij programi, kurrikula e secilit profil dhe kategorizimin e lëndëve/moduleve. Për çdo lëndë, studentit i vihen në dispozicion Syllabus i lëndës, si dhe organizohen Tutoriatet. Evidenca 21: Guida studentore SYLLABUSET e programit TLE https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/ https://kub.edu.al/studio-ne-kub/ Broshura viti akademik 2024-2025: https://drive.google.com/file/d/183T48D4Uf1-s9TzussPRfuqa4sgmahsL/view
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për	GVJ nëpërmjet DVV dhe takimeve me studentët konstaton se: KUB nëpërmjet Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), mban kontakte të vazhdueshme me studentët për të ofruar mundësi punësimi, këshillim karriere si dhe për t'i

orientimin drejt dhe në tregun e punës.	asistuar në hyrjen dhe përshtatjen me tregun e punës. Njoftimet për punësim publikohen vazhdimisht në: • faqen e internetit të KUB, https://kub.edu.al/studentet-2/#punesimi • rrjetet sociale, ose/dhe iu dërgohen studentëve me anë të postës elektronike linqe me oferta të ndryshme. Sipas DVV, evidentojmë se KUB organizon takime të hapura me biznese, industri e organizata në grupe dhe individuale të cilët promovojnë mundësitë e karrierës pranë tyre për studentët. Një mundësi punësimi është praktika profesionale pranë bizneseve që ofrojnë punësime pas mbarimit të saj me të cilat KUB ka marrëveshje bashkëpunimi dhe që në mënyrë konstante merr informacion mbi mundësitë e punësimit. Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese Evidenca 8: Lista e marrëveshjeve për praktika 23-24; 24-25 Evidenca 17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KUB
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ konstaton se institucioni i jep studentëve informacion të gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën e logjistikën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij nëpërmjet: • Stafit akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit; • Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët; • Rregullores KUB/Rregullores së programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”; • Kontratës dy palëshe që nënshkruhet midis KUB dhe çdo studenti, në momentin e regjistrimit; • Javës së Orientimit, që organizohet në fillim të çdo viti akademik. Drejtuesi i Departamentit DSLT mban kontakte të rregullta, njoftime elektronike me studentët që ndjekin programe studimi të Departamentit, për azhurnimin e tyre mbi infrastrukturën, aktivitete të ndryshme, informacione për aktivitetet ekstrakurrikulare, etj. Informacionet e mësipërme studentët e këtij programi studimi mund t'i gjejnë edhe në faqen web të Kolegjit KSLP https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/




	Informacione të tjera lidhur me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor afishohen në vazhdim pranë Sekretarisë mësimore të KUB dhe në ambientet e godinës në këndin e njoftimeve. Çdo informacion tjetër në lidhje me procesin mësimor dërgohen përmes postës elektronike dhe sistemit portali KUB - Teams/Google Classroom Evidenca 21: Guida studentore Evidenca 10: Rregullore e programin TLE Evidenca 72: Njoftime, rrjete sociale, web Evidenca 48: Udhëzues për përdorimin e Google Education Evidenca 63: Udhëzues për përdorim Portali elektronik KUB Evidenca 46: Print Screen i faqes së KUB Evidenca 47: Print Screen i Facebook të KUB
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	GVJ konstaton se Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) në KUB, krahas detyrave të tjera në bashkëpunim me departamentet, punon për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave mësimore, si dhe për të krijuar ura të forta lidhjeje dhe lehtësimin e integritimit në tregun e punës për studentët, si dhe për realizimin e këshillimit të duhur për karrierë. KUB si institucion por edhe DSLT kanë marrëveshje bashkëpunimi ose në institucione apo kompani të zgjedhura nga vet studenti me kusht që me to të nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi. Studentëve u bëhet e qartë se për ndjekjen e praktikës profesionale ka një pedagog tutor për secilin profil. Drejtorja e KSLP ka hartuar dhe miratuar një rregullore të veçantë për zhvillimin e praktikës profesionale. Tabelat përmbledhëse 1-24, tabela 5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese Evidenca 8: Lista e marrëveshjeve për praktika 23-24; 24-25 Evidenca 11 + 12: Rregullore për Praktikën mësimore + Udhëzues për përgatitjen e Praktikës profesionale Evidenca 17: Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KUB
Konkluzione - GVJ vlerëson se KUB ka vënë në dispozicion të studentëve struktura dhe mjete për informim, orientim dhe ndihmë, përkatësisht: - Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët; - Stafin akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit;	

- Rregulloren e KUB / Rregulloren e programit të studimit "Teknik i Lartë Elektrik" me 3 profile: "Energjetikë", "Elektromekanike" e "Automatizim Industrial". - Kontratën dy palëshe që nënshkruhet midis KUB dhe çdo studenti, në momentin e regjistrimit; - Javën e Orientimit, që organizohet në fillim të çdo viti akademik, etj. • GVJ vlerëson se KUB ka vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. • KUB informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ evidenton se Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP) i KUB disponon statistika të plota (regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje) mbi ecurinë e studentëve. Programi i studimit "Teknik i Lartë Elektrik" me 3 profile: "Energjetikë", "Elektromekanike" e "Automatizim Industrial" menaxhohet nga Sekretaria mësimore e KSLP. Këto të dhëna ruhen në formë elektronike dhe në formë të shkruar (hard copy) në regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave sipas mënyrës së përcaktuar në Statutin e Kolegjit Universitar të Biznesit (KUB). Programi i studimit "Teknik i Lartë Elektrik" me 3 profile: "Energjetikë", "Elektromekanike" e "Automatizim Industrial" është ofruar nga KUB për herë të parë në vitin akademik 2023-2024. Evidenca 2: Statuti i KUB, Kreu VII Studentët, nenet 70-78 Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Njësitë administrative të KUB, neni 38 ZBNjAA, neni 40 Sekretaria mësimore + Kryesekretarja; Kreu X Studentët, nenet 79-84 Evidenca 34 + 62 + 84: Raport i ZSKK, Statistika të punësimit të studentëve të KUB për v. 2022-2023

(Signature) *(Signature)*

Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Në takime u theksua edhe roli i Sekretarisë mësimore që mban rekorde të detajuara për studentët e regjistruar, studentët me bursë, të çregjistruarit dhe të pezulluarit me numrin përkatës të matrikullimit për çdo program studimi. Këto statistika mbi studentët i dërgojnë tek Koordinatorja e KUB dhe prej andej tek autoritetet drejtuese. Sekretaria mësimore ka përgjegjësinë e ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit sensitiv që menaxhon. Ky informacion mund të aksesohet vetëm nga persona që autorizohen nga Rektori i KUB. Statistikat vjetore të përpunuara nga të dhënat bazë të studentëve për çdo program studimi pasqyrohen në Raportin e përvitshëm të analizës vjetore të KSLT dhe të KUB dhe i raportohen MAS. Listat e të diplomuarve do të raportohen çdo vit në QSHA. Të dhënat menaxhohen përmes Sistemit të brendshëm të informacionit në KUB. Këto të dhëna janë të sigurta dhe secili nga personat e autorizuar mund t'i verifikojë lehtësisht statistikatat e studentëve. Evidenca 19: Rregullore e Zyrës së Koordinimit Evidenca 78: Rregullore e sekretarisë mësimore Evidenca 57: Raporti vjetor KUB 2023-2024 Evidenca 79: Rregullore arkivi https://kub.edu.al/
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Në Rregulloren e KUB, neni 40, sanksionohen detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarive mësimore dhe të kryesekretares. Rolin e kryesekretares në KUB e luan Koordinatorja e tij (neni 33 në Rregulloren e KUB). Ajo ka autoritetin të kryejë kontroll periodik në sekretaritë mësimore dhe sistemin e menaxhimit të brendshëm për gjendjen dhe saktësinë e dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre dhe problematikën e vërejtur bashkë me propozimet përkatëse ia bën prezent autoriteteve drejtuese të KUB. Dokumentacioni ruhet në format fizik dhe elektronik sipas mënyrës së përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi dhe në rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënia. KUB realizon kontroll të vazhdueshëm dhe menaxhim nga të gjitha njësitë mësimore dhe administrative, në dokumentacione dhe evidencat përkatëse, që lidhen me procesin mësimor dhe veprimtarinë e studentëve. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Databaza elektronike

	e sekretarisë ndihmon në lidhje me vlerësimet për çdo provim, detyrimet e studentëve, etj. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga Rektori dhe strukturat drejtuese. Sipas kërkesave ligjore, institucioni ka të detyrueshme ruajtjen e të dhënave si në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve (notave) dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave në dy forma: hardcopy dhe në formë dixhitale. GVJ konstatoi se për këtë program studimi janë hedhur të dhënat në dy format. Evidenca 2: Statuti i KUB, nenet 76-78 Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Njësitë administrative të KUB, neni 33 Zyra e Koordinimit, neni 38 ZBNjAA, neni 40 Sekretaria mësimore + Kryesekretarja Evidenca 19: Rregullore e Zyrës së Koordinimit Evidenca 78: Rregullore e sekretarisë mësimore
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTL) si njësi përgjegjëse për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, në raportet vjetore mbi veprimtarinë e tij, trajton edhe profilin dhe cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, problemet që dalin dhe merr masa për përmirësimin e tyre. Feedback i vlerësimit të studentëve gjatë praktikës profesionale, mobilitetit në vendet e BE-së si dhe punësimi i studentëve janë tregues që mbahet parasysh në vlerësimin e cilësisë së studentëve. Kjo nga ana tjetër vlen dhe për rishikimin dhe vlerësimin periodik të kurrikulës. Evidenca 30: Raport vjetor i DSLTL për vitin akademik 2023-2024 Evidenca 57: Raporti vjetor KUB për v.a. 2023-2024 Evidenca 34 + 62 + 84: Raport i ZSKK, Statistika të punësimit të studentëve të KUB për v. 2022-2023
Konkluzione - GVJ konstaton struktura të ngritura brenda institucionit në lidhje me menaxhimin e të dhënave të studentëve, si Sekretaria Mësimore, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), Koordinator, etj. - GVJ vlerëson se KUB me Departamentin e Studimeve të Larta Teknike (DSLTL) si njësi përgjegjëse për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial” nëpërmjet këtyre strukturave mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të	

punësimit të tyre.

- *Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga Rektori dhe strukturat drejtuese.*
- *DSLT / KUB hartojnë raporte analitike vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre.*

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstatoi se në Statutin e tij (Kreu VII Studentët, nenet 70-78) KUB ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit dhe organiogramës së saj. Dy strukturat më të larta ku përfshihen studentët janë Senati dhe NjBSC. Këshilli i studentëve është organizëm i pavarur i studentëve të KUB, i zgjedhur në mënyrë demokratike nga vetë studentët dhe përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e tyre. Këshilli i studentëve zgjidhet çdo 2 (dy) vjet nga votat e studentëve, një përfaqësues për çdo program studimi dhe vit studimi. <i>Nga të tre programet e studimit që ofron Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP) janë aktualisht 6 përfaqësues në qeverinë studentore të KUB-it.</i> GVJ konstatoi se në Kreun X Studentët, në nenet 79 dhe 84 të Rregullores së KUB parashikohet përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese. Qeveria studentore ka përfaqësuesin e vet në Senatin Akademik. Gjithashtu, përfaqësues të studentëve ka edhe në përbërjen e NjSBC. Evidenca 2: Statuti i KUB, Kreu VII Studentët, nenet 70-78 Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Kreu X Studentët, nenet 79-84 Evidenca 16: Vendim SA nr. 11, datë 30.09.2024 Strukturat

	mbështetëse (për pjesëmarrjen e përfaqësuesit të studenteve në NjSBC + Këshillit të Etikës) Evidenca 51: Urdhër Rektor nr. 118, datë 26.02.2025 për ngritjen e GVB
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	KUB ka garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në Senatin akademik dhe në Njësinë e Sigurimit të Cilësisë së KUB, etj. Qeveria Studentore shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të KUB, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive, etj. Në KUB studentët bëjnë vlerësimin anonim të pedagogëve me të cilët kanë zhvilluar mësim. Evidenca 16: Vendim SA nr. 11, datë 30.09.2024 Strukturat mbështetëse (për pjesëmarrjen e përfaqësuesit të studenteve në NjSBC + Këshillit të Etikës) Evidenca 51: Urdhër Rektor nr. 118, datë 26.02.2025 për ngritjen e GVB Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Kreu X Studentët, neni 81 Këshillat e studentëve
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTL) ka realizuar diskutime dhe ka kërkuar sugjerime për ngarkesën akademike të studentëve me qëllim përmirësimin e programit të studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Elektromekanike” e “Automatizim Industrial”, si edhe për parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP) dhe DSLTL ka përfshirë studentët në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të programeve lëndore, duke reflektuar sugjerimet e tyre. Këto sugjerime merren në mbledhje të përbashkëta në departament, ose me pyetësorë, ose me grupe fokusimi. Evidenca 30: Raport vjetor i DSLTL për vitin akademik 2023-

	2024 Evidenca 57: Raporti vjetor KUB për v.a. 2023-2024 Evidenca 7: Raport i NjSCB, mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për v. 2023-2024			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ evidenton se sipas rregullores së KUB, neni 98, studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit. Sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashetrojnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës. Nga takimet me studentët, GVJ konstaton se, në rast se studenti ka ankesë për vlerësimin (test në mes të semestrit, detyrë kursi/detyra praktike/ punë laborator, ushtrime, provim përfundimtar), në fillim e sqaron pedagogu i lëndës që e ka vlerësuar. Nëse ka përsëri paqartësi mund t'i drejtohet Përgjegjësit të Departamentit me një kërkesë me shkrim, ku të parashetrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Përgjegjësi i Departamentit ose Rektori, kur pedagogu lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një komision të përbërë nga 3 pedagogë, ku bën pjesë dhe pedagogu i lëndës, për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimit. Evidenca 2: Statuti i KUB, Kreu VII Studentët, nenet 70-78 Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Kreu XII Kontrolli i dijeve, neni 98 Ankimi i rezultateve të provimit Evidenca 10: Rregullore e programin TLE, neni 16 Komunikimi i rezultatit, neni 17 Ankimi ndaj vlerësimit/rezultatit			
Konkluzione - GVJ vlerëson se KUB, me akte ligjore, përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. - GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në NjBSC dhe në Senatin Akademik. - Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre. Kjo përfshirje realizohet me pyetësorët që realizohen çdo vit dhe për çdo lëndë, etj.				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

(Signature)

(Signature)

				X
--	--	--	--	---

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se në orientimin dhe këshillimin e studentëve është i ndarë në dy faza: për maturantët që duan të ndjekin studimet pranë KUB dhe për studentët që tashmë janë regjistruar në KUB. Procedurat/aktivitetet në funksion të pritjes, orientimit, këshillimit të studentëve janë: • Java e orientimit të studentëve; • Faqja internetit/rrejetet sociale; • Rekomandimet e alumnit, etj. Strukturat në funksion të këshillimit të studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave janë kryesisht: – Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), si për informimin për kolegjin; organizimin e jetës studentore, etj; – Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkiv-protokollit (ZBNjAA); – Zyra e Koordinimit; – Struktura dhe anëtare të stafit (në varësi nga natyra e çështjes). Këto njësi/struktura kanë procedura gjithëvjetoare në shërbim të studentëve dhe rregullore të funksionimit të tyre. Në vijim studentët marrin informacion për përdorimin e platformave, llogarive, etj, në KUB nëpërmjet komunikimeve me Sekretarinë Mësimore. Evidenca 2: Statuti i KUB, Kreu VII Studentët, nenet 70-78 Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Njësitë administrative të KUB, neni 33 Zyra e Koordinimit, neni 38 ZBNjAA, neni 40 Sekretaria mësimore + Kryesekretarja, Kreu X Studentët, nenet 79-84 Evidenca 19: Rregullore e Zyrës së Koordinimit Evidenca 78: Rregullore e sekretarisë mësimore

	Evidenca 21: Guida e studentit Evidenca 72: Njoftime, rrjete sociale, web Evidenca 16: Vendim SA nr. 11, datë 30.09.2024 Strukturat mbështetëse (për pjesëmarrjen e përfaqësuesit të studenteve në NjSBC + Këshillit të Etikës) Evidenca 51: Urdhër Rektor nr. 118, datë 26.02.2025 për ngritjen e GVB
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Studenti njihet me informacionin kryesor në lidhje me jetën e tij studentore nëpërmjet “Guidës së studentit”. Sipas RVB e takimeve në institucion, GVJ konstaton se Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP) ofron Tutoriatin gjatë gjithë vitit akademik, sipas semestrave dhe orareve të përshtatshme për pedagogët dhe studentët, si dhe përmes internetit. KSLP iu ofron studenteve edhe seanca konsultuese për çdo lëndë para provimit përfundimtar nga pedagogu i lëndës. Brenda javës nga momenti i daljes së rezultateve të provimit për çdo provim caktohet një orar për seancë sqaruese. Për studentët që hasin vështirësi, KSLP ofron orë/seanca shtesë sipas kërkesës së studentëve ose kur KSLP e gjykon të arsyeshme. Për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit, pjesë përbërëse e të cilit janë: • Sekretaria mësimore e KUB; • Koordinator i programit të studimit në Departamentin e Studimeve të Larta Teknike (DSLTT); • Zyra e Koordinimit, Koordinatorja e KUB; • Tutorët akademikë. Evidenca 2: Statuti i KUB, Kreu VII Studentët, nenet 70-78 Evidenca 3 + 33: Rregullore e KUB, Njësitë administrative të KUB, neni 33 Zyra e Koordinimit, neni 38 ZBNjAA, neni 40 Sekretaria mësimore + Kryesekretarja, Kreu X Studentët, nenet 79-84 Evidenca 19: Rregullore e Zyrës së Koordinimit Evidenca 78: Rregullore e sekretarisë mësimore Evidenca 21: Guida e studentit Evidenca 72: Njoftime, rrjete sociale, web
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës.	Nga organigrama dhe nga RVB kontatojme se strukturat që kanë këtë detyrë janë: Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkiv-

Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	protokollit (ZBNjAA) dhe Zyra e Koordinatorit. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) organizon, menaxhon dhe drejton këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik dhe çështje të tjera të lidhura me to, si dhe bashkëpunon ngushtë me departamentet për organizimin dhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Kjo lidh dhe lehtëson integrimin e studentëve në tregun e punës dhe i shërben realizimit të këshillimit për karrierë. Në sistemin e informimit ndihmon edhe Përgjegjësi i Departamentit të Studimeve të Larta Teknike (DSLTL), i cili jep ndihmesë lidhur me ndjekjen e ecures së studentëve në institucion si dhe për të parë e trajtuar problematikat që ata kanë. Siç është theksuar edhe më lart pjesë e punës informuese janë edhe pedagogët tutorë, faqja e internetit, etj. KUB ka organizuar disa takime të hapura me biznesin, industrinë dhe organizata etj, të cilët promovojnë mundësitë e punësimit të studentëve të KSLP. Evidence 14: Rregullore për Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës Evidenca 21: Guida e studentit Evidenca 72: Njoftime, rrjete sociale, web https://kub.edu.al/events/leksion-i-hapur-mbi-punesimin-e-studenteve-te-kub-nga-tsts-group/ https://kub.edu.al/events/work-study/ https://kub.edu.al/events/projekti-riskman-ne-kotor-mali-i-zi/ https://kub.edu.al/studio-ne-kub/ https://www.youtube.com/watch?v=4RuXsogT33I https://www.facebook.com/watch/?v=445315704308283
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	KUB/KSLP nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës (ZSKK), mban kontakte me studentët e diplomuar, edhe pas përfundimit të studimeve për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, mban një database me të dhënat e çdo studenti të diplomuar, statistikë përkatëse; përpunon statistika dhe gjeneron raporte në lidhje me to për t'ua vënë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. Meqenëse brezi i parë i studentëve akoma nuk është diplomuar, ky proces nuk ka filluar të regjistrohet <i>Të diplomuarit e brezit të parë të programit të studimit "Teknik i Lartë Elektrik" me 3 profile: "Energjetikë", "Elektromekanikë"</i>



	e "Automatizim Industrial" do të dalin në vitin aktual 2024-2025.
--	---

Konkluzione

- GVJ vlerëson se KUB ka procedura e njësi të posaçme (Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkiv-protokollit (ZBNjAA); Zyra e Koordinatorit; Sekretaria mësimore) për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave.
- Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.
- Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) i ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve të programit të studimit, dhe informon organet e autoritetet drejtuese/ose politikëbërëse.

Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Teknik i Lartë Teknik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Automatizim Industrial” e “Elektromekanike”. të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Kolegji Universitar i Biznesit

Pikat e forta dhe afirmime

1. KUB zotëron infrastrukturë dhe ambientet të përshtatshme, me pajisjet e duhura për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrik” me 3 profile: “Energjetikë”, “Automatizim Industrial” e “Elektromekanike”. Laboratorët e KUB kanë teknologji dhe pajisje moderne profesionale të cilët mundësojnë zbatimin në praktikë të dijeve teorike. Infrastruktura pasurohet edhe nga projektet ndërkombëtare ku KUB është partner.
2. KUB ka punuar për ndërkombëtarizimin e bashkëpunimeve dhe programit të studimit duke qenë partner në projekte si Erasmus + (Capacity Building in Higher Education) në kuadrin e komponentit KA1: Mobility for learners and staff in adult education, KA2: Vocational education and training (VET), të mbështetur nga BE. Kjo ka mundësuar:
 - trajnimet të stafit për metoda inovative të mësimdhënies,
 - rritje kapacitësh për stafin akademik dhe administrativ në përgatitje dokumentash strategjikë, si Strategjia e Ndërkombëtarizimit, etj.
 - internship për studentët pranë kompanive europiane. Aktualisht janë zhvilluar praktikat të studentëve pranë kompanive në Slloveni.
3. Personeli është i kualifikuar, me karrierë akademike dhe profesionale. KUB dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkiv-protokollit (ZBNjAA) synojnë që stafi të jetë një kombinim i brezave dhe përvojave. Gjatë periudhës së pandemisë, KUB, mori masat për zhvillimin e mësimin në mënyrë alternative dhe të punës në distancë, duke shfrytëzuar përparësitë e teknologjisë. Kjo u arrit edhe nga krijimi i një mjedisi stimulues dhe motivues për stafin.
4. Veprimtaria akademike dhe administrative kontrollohet nga rregullore/urdhëra/akte rregullatore, që janë publike dhe transparente. KUB, KSLP, DSLT dhe zyrat përgjegjëse synojnë të plotësojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për funksionimin e tij në përputhje të kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në R.SH.” i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Pika të dobta

1. GVJ konstaton që literatura e paraqitur në lëndët profesionale, për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrikë” me profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial” e “Ektromekanike” nuk është e përditësuar me atë të 5 viteve të fundit (Syllabuset e programit të studimit).(Standardi II 4, Kriteri 5)

Rekomandime

1. GVJ rekomandon që të përditësohet literatura e paraqitur në lëndët profesionale, për programin e studimit “Teknik i Lartë Elektrikë” me profile “Energjetikë”, “Automatizim Industrial” e “Ektromekanike” me atë të 5 viteve të fundit.

Evaluation’s conclusions for the professional study program “Higher Electrical Technician” with 3 profiles: “Energy”, “Industrial Automation” and “Electromechanics” provided by the “University College of Business”

Strengths and affirmations

1. KUB possesses appropriate infrastructure and premises, with the necessary equipment for the study program “Higher Electrical Technician” with 3 profiles: “Energy”, “Industrial Automation” and “Electromechanics”. KUB laboratories have modern professional technology and equipment that enable the practical application of theoretical knowledge. The infrastructure is also enriched by international projects where KUB is a partner.
2. KUB has worked on the internationalization of cooperation and the study program by being a partner in projects such as Erasmus + (Capacity Building in Higher Education) in the framework of the component KA1: Mobility for learners and staff in adult education, KA2: Vocational education and training (VET), supported by the EU. This has enabled:
 - staff training in innovative teaching methods,
 - capacity building for academic and administrative staff in the preparation of strategic documents, such as the Internationalization Strategy, etc.
 - internships for students at European companies. Currently, student internships are being developed at companies in Slovenia.
3. The staff is qualified, with academic and professional careers. KUB and the Office of Human Resources, Administration and Archives-Protocol (OHARP) aim for the staff to be a combination of generations and experiences. During the pandemic period, KUB took measures to develop alternative learning and remote working, taking advantage of the advantages of technology. This was also achieved by creating a stimulating and motivating environment for the staff.
4. Academic and administrative activity is controlled by regulations/orders/regulatory acts, which are public and transparent. KUB, KSLP, DSLT and the responsible offices intend to complete all the necessary documentation for its functioning in accordance with the requirements of Law no. 80/2015 “On Higher Education and Scientific Research in Higher Education Institutions in the Republic of Albania” as amended and by-laws

Weaknesses

1. GVJ finds that the literature presented in the professional subjects, for the study program “Higher Electrical Technician” with profiles “Energy”, “Industrial Automation” and “Electromechanics” is not updated with that of the last 5 years (Syllabuses of the study program).

Recommendation

1. GVJ recommends updating the literature presented in professional subjects for the study program “Higher Electrical Technician” with profiles “Energy”, “Industrial Automation” and “Electromechanics” with that of the last 5 year

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit të studimit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

(Signature) *(Signature)*